

MATERIAL MËSIMOR

Në mbështetje të mësuesve të drejtimit mësimor

“Pyje”, Niveli I

Ky material mësimor i referohet:

Lëndës profesionale: “Dendrologji”, (L-25-140-17), Kl. 10 – 72 orë

Në profilin mësimor “Pyje”, Niveli I

Temave mësimore:

- Objekti dhe rëndësia e dendrologjisë
- Njohuri për ekologjinë pyjore
- Bimët pyjore farëzhveshura
- Bimët pyjore farëveshura. Fam:shelgore,arrore,mështekore
- Bimët pyjore farëveshura. Fam:ahore,vidhore,trendafilore
- Bimët pyjore farëveshura. Fam:bishtajore,panjore,blinore
- Bimët pyjore farëveshura. Fam:ullinjore,dhe të tjera familje
- Bimet mjeksore e industriale

Përgatiti: Ing. Gjon Fierza

Tiranë, 2019

TEMA MËSIMORE NR.1: Objekti dhe rëndësia e dendrologjisë

1.1 Objekti

Gjatë veprimtarisë se tyre pylltarëve u bëhen shumë pyetje, ndër ato më të shpeshta është: Pylltar! Çfarë lloj druri apo peme është kjo? Shpesh pylltarët e rinj dhe pa përvojë, nuk japin dot përgjigje shpejt dhe saktë kur e dëgjojnë këtë pyetje të shkurtër. Për tju përgjigjur saktë dhe shpejt cdo pylltar duhet të njohë dhe të mësojë mirë lëndën e Dendrologjisë si një ndër lëndët bazë të pylltarisë.

Dendrologjia (degë e Botanikës, disiplinë e Silvikulturës) është shkencë që merret me studimin e bimëve, që kanë rritje dytësore, dmth që prodhojnë dru (pemë, shkurre dhe lianë). Dendrologji do të thotë “studim i drurëve” apo shkencë që studion drurët. Në përdorimin e përditshëm mund të themi ndryshe si mënyra për të klasifikuar speciet drusore (taksonomi), që nuk është gjë tjetër veçse klasifikimi, emërtimi dhe identifikimi i pemëve, në bazë të kërkesave dhe marrëdhënieve natyrale si dhe shtrirjen gjeografike të specieve (areali). Njohja e emrave të drurëve dhe shkurreve pyjore, morfologjia, kërkesat ekologjike dhe vlera e tyre është themelore për pylltarët në terren, dhe studimet e avancuara në pylltari. Dendrologu, mëson jo vetëm identifikimin e drurëve, ai duhet të përcaktojë ku ai mund të zhvillohet normalisht si dru pyjor, të ketë njohuritë dhe të zbatojë metodat për të qenë në gjendje të identifikojnë speciet e panjohura.

1.2 Rëndësia e dendrologjisë

Dendrologjia është një mjet për të njohur dhe për të studiuar drurët dhe shkurret. Emrat shërbejnë si një udhëzues për t’iu referuar drurëve. Para se të bëhet një studim i burimeve pyjore të një vendi është e nevojshme të njihen emrat e specieve. Gjithmonë, pylltarët duhet të dinë emrat e pemëve të rëndësishme me të cilat punojnë. Dendrologjia, e quajtur edhe dendrologjia e pyjeve merret me studimin e karakteristikave të drurëve, shkurreve dhe bimëve të tjera drunore. Dendrologjia në përgjithësi konsiderohet të jetë një degë e botanikës sistematike ose e pyjeve dhe kryesisht merret me taksonominë e llojeve të drurit. Në një nivel bazë, dendrologjia u mëson botanistëve dhe pylltarëve nomenklaturën dhe klasifikimin e bimëve pyjore dhe si të përdorin karakteristikat morfologjike dhe informacionin e habitateve për të identifikuar speciet e panjohura.

1.3. Pse të studiosh dendrologjinë?

- Nomenklatura e drurëve. Për të mësuar se si janë emërtuar drurët, duke përfshirë emrat shkencorë, emrat e zakonshëm dhe kodin e nomenklaturës botanike.
- Klasifikimi i bimëve. Për të mësuar se si pemët klasifikohen në familje, gjini, dhe grupe të tjera sipas rregullimeve të tyre. Për të mësuar emrat dhe karakteristikat e familjeve botanike të zakonshme dhe të rëndësishme të drurëve
- Identifikimi i drurëve. Të jetë në gjendje të vendosni një pemë të panjohur në familjën e saj. Të mësosh se si të gjesh emrin e pemëve të panjohura ose të identifikosh pemë me anë të çelësave, manualeve dhe florave.
- Të njihni librat referente për identifikimin e pemëve të vëndit tuaj. Të mësosh se si të mbledhësh mostrat botanike. Të mësosh se si të ruash dhe të përdorësh një herbarium.
- Shpërndarja e drurëve. Për të mësuar se si drurët pyjor shpërndahën në zonat klimatike, shpërndarjen gjeografike të drurëve të rëndësishëm pyjore.
- Pemë të rëndësishme pyjore. Të njohim drurët pyjore më të rëndësishme të vëndit tuaj, duke përfshirë emrat shkencorë, emrat e zakonshëm, familjën, shpërndarjen sasinë në vëllim dhe sipërfaqe si dhe përdorimet kryesore.

1.4. Ç’është dendrologjia urbane.

Dendrologjia urbane ka si objekt drurët në pyjet urban. Në dekadën e fundit ka marrë një rëndësi të madhe studimi i drurëve dhe i peizazheve që krijohen në mjediset urbane (të banuara). Pyje urbanë janë të gjithë drurët dhe vegjetacioni tjetër që rriten në vendet ku njerëzit jetojnë, punojnë dhe lëvizin, që nga komunitetet e zonave rurale deri tek qytetet metropolitane të mëdha. Ato, përfshijnë drurët në ambiente publike dhe private, përgjatë rrugëve, në zona rezidenciale, parqe e zona tregtare dhe vende të tjera me

njerëz. Druret, janë një pjesë e rëndësishme e komuniteteve tona, por mbjellja, mirëmbajtja dhe mbrojtja kërkojnë investime, të cilat, janë shumë të pakta krahasuar me përfitimet. Mënyra më e mirë për të arritur përfitimin maksimal nga një pemë e mbjellë është që të zgjidhet lloji i duhur drusor ose shkurret për vendin e duhur.



Pylli urban, kontribuon në qëndrueshmërinë ekonomike të një komuniteti, duke rritur vlerën e pronës. Shumica e njerëzve, mendojnë se lagjet me gjelbërim dhe drurët janë vendet më tërheqëse për të jetuar. Vlera e shtëpive në këto zona është në përgjithësi më e lartë se ato të krahasuara me të mbjellura sipas një dizenjimi të caktuar ose të rritura rastësisht, shtëpi në lagje pa shumë gjelbërim ose aspak.

Pemët mund të ndihmojnë në uljen e kostove të ngrohjes dhe ftohjes duke hijëzuar ndërtesat, duke vepruar si frenues të erërave dhe freskimit të ajrit gjatë procesit të frymëmarrjes së bimëve. Kur mbjellim një pemë për arsye të uljes së kostove të energjisë, specia drunore, vendodhja, lloji i ndërtesës duhen të merren në konsideratë.

Drurët, sidomos ata me gjethe të përmasave të mëdha, përthithin dhe kapin ndotësit që qarkullojnë në ajër dhe grimca kimike, siç mund të jenë okside të azotit, dioksid sulfuri, monoksid karboni dhe ozonin. Pemët, duke reduktuar shpejtësinë e erës ndihmojnë dhe në frenimin e grimcave të mëdha që ngrihen në ajër. Komunitetet përfitojnë jo vetëm ajër më të pastër por dhe reduktojnë kosto që mund të përdorëshin për frenimin e ndotësve të ajrit në dhe materialet e shtëpive apo zyrave. Drurët pyjor të pozicionuara në mënyrën e duhur mund të reduktojnë kostot e ngrohjes për ndërtesat.

TEMA MËSIMORE 2. Njohuri për ekologjinë pyjore

2.1. Çfarë është ekologjia

Jeta në pyll si në natyrën e lire zhvillohet sipas një ritmi të caktuar, që karakterizohet me ndikim dhe impakt të lartë nga efekti i një numër të faktorëve ekologjik ose ndryshe mund të emërtohen si faktorë vegjetativ.

Ekologjia quhet ndryshe shkencë e ekosistemeve. Qeniet e gjalla të cilat jetojnë në pyll, kanë marrëdhënie shumë të ngushta dhe të përhershme me njëra-tjetrën. Këto marrëdhënie si dhe faktorët që ndikojnë në këta organizma i studion shkencat e Ekologjisë.

Ekologjia nuk është sinonim me mjedisin, ambientalizmin, historinë natyrore, apo shkencat e mjedisit. Ajo është e lidhur ngushtë me biologjinë evolucionare, gjenetikën, dhe etologjinë. Degë e veçantë e ekologjisë është edhe ekologjia pyjore, e cila në vete studion si faktorë jo të gjallë kimik dhe fizik në lidhje me pyllin.

2.2. Ekologjia pyjore

Njohja e faktorëve ekologjik është me shumë rëndësi për dendrologun, pylltarët në përgjithësi. Çdo dru apo shkurre pyjore e ka të përcaktuar së shumti gjallesën dhe zhvillimin e tij të kushtëzuar nga faktorët ekologjik. Ekologjia pyjore mund të përkufizohet si shkencë e ekosistemeve të pyllit, e cila merret me studimin e adaptimeve të specieve pyjore, me strukturën dhe dinamikën e populacioneve dhe biogeocenozave të pyllit si edhe të raportit të këtyre me mjedisin abiotik në kuadrin e ekosistemeve. Problemi qëndror i ekologjisë pyjore, analizimi i pyllit si ekosistem për të përcaktuar ligjësitë e përbërjes dhe të funksionimit në një mjedis të caktuar gjeografik.

2.3. Mjedisi dhe faktorët ekologjik

Tërësia e faktorëve të cilët përcaktojnë mjedisin rrethues merr emrin faktor ekologjik, kushte ekologjike ose kushte të mjedisit. Nga kjo tërësi faktorësh ekologjike, secila specie pyjore përdor vetëm një pjesë të caktuar, e cila përfaqëson për atë, të ashtuquajturat kushte të ekzistencës që i janë të nevojshme dhe të domosdoshme për jetesën. Faktorët ekologjike grupohen në pesë grupe:

1. Faktorë klimatik: nxehtësia, drita, era, perberja e ajrit, elektriciteti i atmosferës.
2. Faktorë edafik: toka me vetite fizik, kimike e mekanike, shkëmbi amnor, lëgusha.
3. Faktorë topografik: altituda, kundrejtimi, pjerrësia, mikrorelievi.
4. Faktorë biotik: shtazore dhe bimore.
5. Faktorët antropikë (njerezor): ndikimi i njeriut mbi bimësinë pyjore.

2.4. Shpërndarja e bimësisë në vendin tonë. Vendi ynë paraqitet me një larmi mjedisesh fiziko-gjeografike, të cilat ndikojnë fuqimisht mbi bimësinë dhe përcaktojnë një ndarje të theksuar të territorit, si në krahina ashtu dhe në shkallë lartësie. Në përcaktimin e zonave fitoklimatike të vendit tonë, është patur parasysh parimi që nga klasifikimet e përgjithëshme të kalohet në përcaktimin e mjedisit lokal. Territori i vendit tonë, ndahet në 5 zona fitoklimatike si më poshtë:

2.5. Zonat fitoklimatike të Shqipërisë

1. Zona e Dafinës (*Lauretum*)


Në zona e nxehtë; shtrihet gjatë bregdetit Jon, nga Kepi i Stillos deri në Kepin e Gjuhes (Karaburun), vazhdon rreth gjirit të Vlores deri në Zvernec, në rreth 200 dhe 300 lartësi mbi nivelin e detit. Bimësia e kësaj nënzona përfaqësohet nga shoqëri bimore tipike gjithmone të blerte me karakter kserofit. Në luginat apo faqe me të fresketa, zbrasin edhe specie të zonës së Geshtenjes. Në zona e mesme dhe e ftohtë shtrihet gjatë bregdetit Adriatik, nga Dajlani i Vlores deri në Pulaj, midis 300 dhe 600 (800) m lartësi mbi det. Nëper luginat të lagëta dhe shpate të fresketa, zbrasin edhe specie gjithmone të blerta dhe kserofite të zonës së Geshtenjes si: Geshtenja, arra e bute, qarri, bunga, blinjet, shkoza, melleza, vidhi, plepat; shëlgjet, etj. Bimësia e nënzonaës së ftohtë është si ajo e të mesmes, por më pak e pasur në specie termofile, që zbrasin nga zona e Geshtenjes.

2. Zona e Gështenjës ose Dushqeve (*Castanetum*)

Në zona e nxehtë (tip me thatësire verore) shtrihet midis 600 (800)–1000 m lartësi mbi det. Në këtë nënzona bimësia përbëhet nga Gështenja, bunga, qarri, shparthi, arra, shëlgjet, plepat, shkozat, melleza,

verriu zi, vidhi, lajthia, bushi, ashja, blijtë, panja fletëgjërë, krekeza fletëmadhe dhe fletevogel, shqopa, dellinja e zeze, bershëni, thana murrizat, etj. Nenzona e ftohte (tip me reshje vjetore > 700 mm), shtrihet midis 1000-1200 m lartësi mbi det. Bimesia është e njëjte me atë të nenzonës së nxehur, por takohen me rralle elemente termofil si shparthi, casaci, ilqja, melleza etj.

3. Zona e Ahut (*Fagetum*)



etj, dhe bimët barishtore spontane alpine

Nenzona e ngrohtë. Këtu mbizotëron kryesisht pisha e zezë, bredhi i Maqedonisë dhe ahu. Takohen gjithashtu tisi, dëllinja e zeze, bershëni, bunga, qarri, bungebuta, disa shelgje, plepi i egër panja fletëgjërë dhe e malit, krekeza fletëvogël, shkoza e bardhe, lajthia e bute dhe e eger, verriu i zi, vadheviçet shtogu i zi, frashnjat, bushi, blijtë, platyphyllos, geshtenja e kalit, murriza ashja, boshtra etj. Në zonën e ftohtë zoteron kryesisht ahu. Takohen gjithashtu, bredhi i bardhe dhe bredhi i Maqedonisë, pisha e zezë, arneni, rrobulli, hartina, hormoqi, tisi, dellinjat e ndryshme, plepi i egër, meshtekna, bunga, qarri, bungëbuta, lajthitë, panjat.

4. Zona e Hormoqit ose e Rrobujve (*Picetum*)

Kjo zonë është e kufizuar në vendin tonë dhe kap një rryp të ngushtë mbi zonën e ahut. Ajo shtrihet midis 1700 (1800) – 2000 (2200) m lartësi mbi det. Bimësia e kësaj zonë përfaqësohet nga rrobulli; arneni; kërleka; jermesina Meqene se, në këtë zonë, si nga shtrirja ashtu edhe nga rëndësia që paraqesin, mbizoterojnë rrobujt dhe arneni, mund të quhet thjeshtë edhe zona e rrobujve.

5. Zona Alpine (*Alpinetum*)

Perfshin lartësinë mbi zonën e hormoqit. Ajo shtrihet mbi 2000 (2200) m lartësi mbi nivelin e detit. Në këtë zonë takohen speciet pyjore: kërleka, rrobulli, dëllinjat, shelgjet; pjerrëzat; trëndafilat e egër, xerxolja,

TEMA MËSIMORE NR.3 Bimët pyjore farëzhveshura

3.1. Morfologjia e drurëve pyjor




Njohuritë tona mbi dendrologjinë dhe aftësitë për të identifikuar janë të lidhura me njohjen e organeve të drurëve siç janë: rrënjët; trunngu me levorën, gjethet, sythat, lulet apo frutat që i japin pemës identitetin e tyre të veçantë.

Sipas lartësisë që realizojnë drurët grupohen:

- Drurë të madhësisë parë që realizojnë lartësi mbi 25 m
- Drurë të madhësisë dytë që realizojnë lartësi 15- 25 m
- Drurë të madhësisë tretë që realizojnë lartësi 7-15 m

Shkurret janë bimë drunore që nuk kalojnë 7 m lartësi, zakonisht kanë dy a më shumë kërcëj dhe degëzohen qysh në bazë në formë tufe.

Organet kryesore të një bime pyjore janë: rrënja, kërcelli (trunngu) me lëvorën, bisqet, sythat, gjethet, lulet, frytet.



Kercelli drunor



b. Rrënjët anësore janë kur nuk ka një rrënjë

Rrënja, është pjesa kryesisht nën tokë e një bime (një shkurreje dhe një druri). Ajo ka dy funksione kryesore, e mban bimën të ngulur në tokë dhe i shërben bimës për të thithur ujin dhe lëndet e tjera ushqyese; Tek drurët pyjor rrënjët grupon në rrënjë boshtore, anësore (xhufkore) dhe të përziera. Te bimët dythelbore dhe të shumë bime njethelbore, indet perberese te rrënjës vendosen në tre shtresa bashkëqëndrore.


a. Rrënjët boshtore, kanë formën një bosht të dallueshem që pastaj në gjatësinë e tij dalin shumë rrënjë të tjera. Ato e pershkojnë token në thellësi mbi 1 m.

kryesore të zhvilluar, shtrihen në sipërfaqe horizontale dhe nuk arrijnë në thellësi më shumë se 0.5 m.
c. Boshtore-anesore konsiderohen ato sisteme rrënjore kur rrënjët anësore dhe ajo qendrore kanë një zhvillim të barabarte.

Kërçelli me lëvorën, është pjesa mbitokesore e drurit dhe rritet në drejtim të kundërt me rrënjën. Ai ka si funksion kryesor mbajtjen e organeve mbitokësore të bimës, të përcjellin ujin dhe lëndet ushqyese drejt kurores. Sipas drejtimit që merr kërçelli i një bime është; i drejtë (kyesisht tek haloret); i përdredhur, i shtrirë, i kacavarur, etj.


Bisqet janë degë të vogla që rriten në një vit. Mbi to gjenden sythet, gjethet lulet dhe frutat. Sythet janë organe vegjetative në majë dhe në anë të degës së drurit, nga ku shpërthejnë; gjethet, lulet dhe rriten bisqe të reja. Sipas pozicionit kemi sytha anësorë, sytha të majes. Kemi sythe të fjetur, që nuk zhvillohet në atë periudhë vegjitacioni.

Gjethja, është organ kryesor i cili kryen procese të cilat janë shumë të rëndësishme, jo vetëm për bimën, por dhe për ekzistencën e botës së gjallë. Gjethet janë "fabrika" ku përgatitet ushqimi i bimës. Gjethet gjithmone thithin dioksid karboni dhe nxjerrin jashtë oksigjen duke realizuar procesin e fotosintezes dhe transpirimin e ujit. Gjethet kanë forma të ndryshme. Ato janë pothuajse me ngjyrë të gjelber. Kanë forma dhe permasa të ndryshme dhe janë unike për çdo bimë.



Lulja përfaqëson një bisk të shkurtër të padegëzuar dhe me rritje të kufizuar, që shërben për formimin e sporeve, me pas gameteve, për proceset seksuale mbas së cilave formohen frutat dhe farat. Pjesët kryesore të dukshme të lules janë: sepalet ose nenpetalet, petalet, theket e pistili janë pjesët kryesore të lule janë mashkullore e femërore. Lulet janë njëseksore dyseksore.

Fryti dhe fara janë produkte të bimëve drunore në madhësi të ndryshme që zhvillohen, pasi pllenohet vezorja e lules. Disa fryta konsumohen nga njeriu dhe kafshët. Fara shërben kryesisht për të shumuar bimët në kushte natyrore apo dhe artificiale. Çdo lloj drusor



Gjethet e thjeshta druresh me buzë dhe forma të ndryshme

ka frut dhe farë të vecante, njohja e tyre shërben jo vetëm në përcaktimin e saktë të llojeve drusore por dhe në shtimin e tyre dhe për studime të ndryshme të karakterit gjenetik dhe përmirësim të llojeve. Frytet mund janë të theshta dhe të përbëra, të hapsëm dhe të pahapsëm.




gjethe haloresh



gjethe fletoresh



gjethe të përbëra-fletor



Disa forma kryesore te gjetheve te drureve dhe shkurreve

Fruta te kështerave			Fruta te kështerave		
					
Brukic	Përbërës / Draps	Malis	Revanakën	Difitaje	Kasabë
			Fruta te fruteve qe nuk hapen		
Mangod	Exotike				Akru
					Akru
Antegjere	Strawberries	Frut			Katëps
					Shipe
					Shipe
					Shipe
					Shipe
					Shipe
					Shipe
					Shipe
					Shipe

Tipe frutash

3.2 Sistematika dhe emërtimi i bimëve

Sistematika e bimëve, degë e botanikës merret me sistemimin, grupimin dhe emertimin e bimëve ku përfshihet dhe bimësia pyjore, si bimësia më e rëndësishme në jetën në tokë. Në këtë tabelë jepet grupi i bimëve ku përfshihen dhe drurët pyjor. Me hollësi për këtë flitet në sistematikën e bimëve. **Skema jep si dhe ku klasifikohet bimesia pyjore që rritet dhe zhvillohet ne vendin tonë.**

GRUPIMI	PËRCAKTIMI
Mbretëri	Gjithë gjallesat janë të klasifikuara nën mbretëri (bimë dhe kafshë) Drurët pyjor, janë nën mbretërinë e bimëve.
Divizioni	Kjo është kategoria e parë e mbretërisë së bimëve dhe është e bazuar në pjesët e bimëve për riprodhim . Bimet Spermatofite janë ato bimë që riprodhohen me farë.
Klasa	Më pas pemët ndahen në dy klasa, Gjymnospermët dhe Angiospermët, kjo sipas metodës se si zhvillohen farat që përdoren për riprodhim. Gjymnospermët siç janë halorët, prodhojnë fara të hapura në një strukturë që është boçja. Angiospermët janë drurë që lulëzojnë dhe farat i kanë të mbyllura në vezore.
Rendi	Drurët më tej janë të klasifikuara në rende sipas disa karakteristika të tjera të riprodhimit me fara. Angiospermët janë të ndara në dy grupe kryesore: monokotilodonet dhe dikotilodonet, bazuar pjesërisht në nr. e gjetheve embrionale (një ose dy) në farat e bimëve. Shumica e drurëve janë dikotilodone.
Familja	Janë një grup pemësh me lidhje të përbashkëta. Familja e trëndafilave (Rosaceae) është një familje në grupin dikotilodon dhe përfshin qershinë, mollën, kumbullën dhe pemën e pjeshkës.
Gjinia	Një përmbledhje e specieve me lidhje të përbashkëta përbëjnë gjininë. Speciet janë strukturalisht të ngjashme ose kanë paraardhës të përbashkët. Shembull është qershia dhe kumbulla, (gjinia prunus) që janë pjesë të familjes së trëndafilave.
Specia	Bashkim individësh me karakteristika të ngjashme që tregojnë se kanë paraardhës të përbashkët, një specie është një pemë e dallueshme dhe e pangjashme me të tjerët.

Bimët drunore janë bimët që çelin lule dhe riprodhohen me farë sistemohen në grupin


Spermatofite që ndahën në: Gymnosperme (Farëzhveshurat) dhe Agyosperme (Farëveshurat) Te keto nendarje ka vecori te theksuar tek pamja e jashtme e drureve tek dhe morfologjia e tyre, ndertimi dhe forma e organeve te ripr dhimit etj. Në Gjymnosperme (Farëzhveshurat) bëjnë pjese disa lloje te gjinive pishë, bredh, ceder, selvi qe kane nje rëndësi të vecantë në përberjen e pyjeve të vendit tone.

Emërtimi i drurëve. Kemi një emertim në shqip të drurëve dhe shkurreve. Shumë specie drunore në krahina të ndryshme kanë dhe emertime të ndryshme që lidhen me dialektin dhe të folmen tradicionale.

Emertimi shkencor. Sistemi latin i emërtimeve të bimëve (shek.18) përdoret në të gjithë botën si një sistem i unifikuar për emërtimin e drureve dhe shkurreve si pjese e terësise së botës bimore. Emërtimi i plotë për një specie ka zakonisht tre pjesë:

Gjinia, për pishën e zezë është “Pinus”; **Specia**, për pishën e zezë është *Pinus nigra*; Emri i plotë (*Pinus nigra L* (L është iniciali i botanistit Lineu)

3.3 Përshkrimi i disa llojeve me kryesore nga Rendi i Halorëve.
FAMILJA E TISOREVE, permbledh rreth 12 gjini me lloje te



Taxus baccata

shpendara ne gjithë botën nga zonat e ngrohta në ato të ftohta. Në Shqipëri kjo familje përfaqësohet vetem me llojin Tis.

Tisi (*Taxus baccata* L)

Është dru i kategorise II. Trupi, rritet i drejtë ose ne formë shkurrje dhe arrin deri 15 m lartësi, deri 1 m diameter. Rrënja është boshtore dhe anesore. Lëvorja e e murrme e kuqërremet, në moshë të madhe kalon në hiri. Kurora e drurëve të vetmuar është piramidë e gjërë. Bisqet janë të blerta në të verdhë. Sythet janë të vegjël, të blertë dhe të grumbulluar në majën e bisqeve. Gjethet janë halë vijëzake me majë, të buta deri 3 cm te gjata, 2-3 mm të gjëra, në pjesën e sipërme me shkëlqim. Janë helmuese pasi në përmbajtje sikurse dhe druri kanë taksinë. Lulet janë njëseksore dioike dhe rrallë herë njëseksore, janë në formë gathësh, çelin në mars-prill. Fruti është një rrushkë e kuqe me bërthame; Farat piqen në periudhën gusht-shtator. Frutifikon çdo vit. Shumëzimi bëhet me farë ose me llastarë. Ritja është ngadalshme, dhe jeton 400-600 vjet ka raste dhe deri 2000 vjet. Ka vlerë përdorimi si dru për zbukurim në parqet urban, ka vlerë druri për gëdhëndje dhe përpunim. Ka vlerë si një element i rëndësishëm i biodiversitetit me pyjet. Duhet dhe mund të përdoret më shumë duke e mbjellur. Ai është lloj në rrezik zhdukje dhe është me statusin “lloj i mbrojtur”.

FAMILJA HALOREVE (PISHORE, BREDHORE). Në vendin tonë nga kjo familje gjënden kater gjini: e bredhave (*Abies*); e pishave (*Pinus*); e hormoqit (*Picea*), e cedrave (*Cedrus*), pseudosuge (*Pseudotsuga*). Kjo përfaqësohet më shumë lloje drurësh më vlëra. Gjinia e Bredhave (*Abies*) në tërësi përfshinë rreth 50 lloje drurësh. Në vendin tonë rriten dhe zhvillohen tre lloje. Bredhi i Greqise, Bredhi i Maqedonisë dhe Bredhi bardhë (*Abies alba* Mill)

Bredhi i bardhë (*Abies alba* Mill)

Përshkrimi. Është dru i kategorisë I. Trupi rritet i drejtë cilindrik dhe arrinë deri 50 m lartësi, deri 2 m diametër. Rrënja është boshtore dhe më vonë merr një zhvillim të madh anësore. Lëvorja ngjyrë hiri me luspa. Kurora e drurëve është konike dendur. Dëgezat janë të përhime në të verdhë. Sythet janë në trajtë vezake. Gjethet janë halë vijëzake me majë, të buta deri 3cm të gjata, 2-3 mm të gjëra, në pjesën e sipërme me shkëlqim, në pjesën e poshtme kanë dy vija të bardha. Lulet janë njëseksore monoike. Lulet mashkullore janë në formë gathësh te gjatë me ngjyre si të verdhe, dalin ne faqen e poshtme të degeve. Lulet femrore kane formë cilindrike dalin në majen e degeve, çelin në mars-prill. Fruti është një boçe me gjatësi 10-15 cm dhe trashësi 3-5 cm; Farat është 7-9 mm e madhe me tre kënde, piqen në periudhën shtator-tetor. Frutifikon çdo 2-3 vite. Fuqia mbirëse deri 50%. Shumëzimi bëhet me farë. Rritja është ngadalshme në 1-15 vitet e para pastaj ka rritje të madhe dhe jeton 150-200 vjet, ka raste dhe më shumë. Druri ka blannë të bardhë butë, çahet me lehtësi, myja nuk ka ngjyrë të veçantë, është i lehtë,

Kërkesat ekologjike dhe përdorimi. Rritet në klimë mesdhetare kontinentale, pëlqen tokat e murrëme pyjore të thella, me përberje subargjilore të mesme, të freskëta, mjediset në hije dhe me pak lagështi atmosferike. Është dru hijedashes, filizat e rinjë rriten dhe zhvillohen shumë vite ne hije, pasi aty gjejnë kushte dhe mbrojtje nga ngricat dhe rrezatimi diellor. Zhvillohet mirë i përzier me ah. **Ka vlerë përdorimi si një element i rëndësishëm i biodiversitetit me pyjet që formon;** si



dru për zbukurim në parqet urban, ka vlerë druri për përpunim. Duhet dhe mund të përdoret më shumë duke e mbjellur. Ai është lloj në rrezik zhdukje dhe është me statusin “lloj i mbrojtur”

Gjinia e Hormoqeve (Picea) përfshinë rreth 50 lloje druresh në botë. Në vendin tonë përfaqësohet me një lloj që rritet në gjendje natyrore.

Hormoqi (Picea excelsa Wall)

Është dru i katëgorisë I. Trupi rritet i drejtë cilindrik dhe arrinë deri 25-30 m lartësi, deri 1 m diametër. Rrënja është më tepër anësore. Lëvorja ngjyrë kuqerremët. Kurora e drurëve është konike me majë të holluar. Deget në nivele të ndryshme mbajnë drejtime të kundërta, të majes janë lart, në mes janë horizontale dhe në fundin e trungut varen poshtë. Degezat janë të murrme në të kuqërremet. Sythet janë me rreshirë, të majes janë konike të hollë. Gjethet janë halë 1-2.5- 3cm të gjata, 2-3 mm të gjëra, në pjesen anësore kanë vija të bardha. Lulet janë njëseksore monoike. Lulet mashkullore janë në formë gathësh 1.5 cm të gjatë me ngjyrë të kuqe në të verdhë. Lulet femrore dalin në sythet në majën e degeve të cilat kur pjalmehohen kthehen poshtë. Fruti është një boçe me gjatësi 10-15 cm dhe trashësi 3-4 cm. Farat janë të vogla me flater me ngjyrë të murrme me tre kënde, piqen në periudhen shtator-tetor. Frutifikon çdo 2-3 vite. Fuqia mbirese deri 50%. Shumezimi behet me farë . Rritja është ngadalshme pastaj ka rritje të madhe sidomos në lartësi. Druri ka ngjyrë të bardhë butë, është elastike është i lehtë.

Kërkesat ekologjike dhe përdorimi. Në vendin tone, ka përhapje të kufizuar. Gjendet vetem në zonën e ahut, kryesisht në Luginën e Valbonës në lartësi 1000-1500 m mbi nivelin e detit. Gjendet i shoqeruar me ahun, bredhin dhe arnenin. Rritet në klimë mesdhetare kontinentale, pëlqen tokat e murrme pyjore të thella, me përbërje subargjilore të mesme, të freskëta në mjediset në hije dhe me pak lagështi atmosferike. Është më dritedashës se bredhi i bardhë. Kur rritet me halorë të tjerë toka ka reaksion të theksuar acid. Ka vlerë përdorimi si një element i rëndësishëm i biodiversitetit me pyjet që formon si dru me pjesëmarrje; si dru për zbukurim në parqet urban, ka vlerë druri për përpunim sidomos për vegëla muzikore. Duhet dhe mund të përdoret më shumë duke e mbjellur sidomos në Valbonë apo zona të tjera të ngjashme. Ai është lloj në rrezik zhdukje dhe është me statusin “lloj i mbrojtur”

Gjinia Cederave (Cedrus). Në botë përfaqësohet nga shumë lloje druresh me permasa të mëdha ku disa lloje e durojnë shume thatësi. Në vendin tonë njihen tre lloje që janë kryesisht të kultivuar si drurë zbuqurues në parqe.

Cedri i Libanit (Cedrus libani A.Rich),

Është i njohur zakonisht si cedri i Libanit simbol i këtij shteti, është një dru i pellgut të Mesdheut Lindor. Arrinë lartësinë prej 40m, përdoret gjerësisht si një pemë dekorative në parqe dhe kopshte. Trungjet mbulohen degë të mëdha, të ngritura që rriten në një madhësi dhe marrin një prirje horizontale, të gjerë. Kurora është konike kur është e re, pastaj druret e rritur kanë formë piramidale. Lulezon në vjeshtë, lulet mashkull shfaqen në fillim të shtatorit dhe ato femra në fund të shtatorit. Bocet janë 8 deri në 12 cm të gjatë dhe 3 deri në 6 cm trashësi. Druri i kedrit është shumë i çmuar për grurin e tij të imët, ngjyrën e verdhë tërheqëse dhe aromën. .

Gjinia Pishë (Pinus), është me rëndësishmja familjes së konifereve. Në vëndin tonë rritën disa lloje pishash; në gjëndje natyrore dhe të kultivuara, formojnë kështu pyje të thjeshtë dhe të



perzier duke filluar nga zona bregdetare deri në zonen e kullotave alpine. Disa lloje pishash kanë rëndësi si drurë zbukurues në parqe dhe në gjelberimin e rrugëve dhe mbrojtjen e tokës nga gerryerjet, ”si dru pionier”. Ndër pishat që rritet në gjendje natyrore në vendin tonë më e rëndësishme është pisha e zezë. Ndër pishat e kultivura kanë rëndësi pisha e detit, pisha e butë dhe pisha eger.

Pisha e zezë (*Pinus nigra* Arn.) Eshhtë dru i kategorisë I. Trupi rritet i drejte cilindrik dhe arrinë deri 30-45 m lartësi, deri 2.5 m diameter. Rrënja është më tepër me zhvillim anësor. Lëvorja ngjyrë të kuqerremet në të erret me shumë luspa. Kurora e druveve është piramidale si dru i vetmuar, në pyll ajo ka formë ombrelle. Degët e reja janë të blerta në të verdhë me shume shkelqim. Sythet janë me rreshirë, në trajtë konike deri 2 cm të gjatë. Gjethet janë halë 8-15 cm të gjata, të forta me majë shpuese, në anë kanë dhëmbëzim të imet. Lulet janë njëseksore monoike, celin në maj-qershor. Lulet mashkullore janë në formë gathësh 1.5 -2.5 cm të gjatë me ngjyrë të kuqe në të verdhë. Lulet femrore dalin në sythet në kryesisht majen e dgeve . Fruti është një boçe pa bisht me gjatesi 5-8 cm ka ngjyrë të murrme në të zezë. Farat janë 5-6 mm me një flater me ngjyrë kafe të hapët, piqen në periudhën shtator-tetor të vitit të dytë. Frutifikon çdo 2-3 vite. Fuqia mbirese deri 80%. Shumezimi behet me farë. Rritja është e madhe sidomos në moshë të re në lartësi. Druri ka ngjyre të kuqe, është e qendrueshme me shume kanale rreshire, e lehte në perpunim, elastike është i lehtë. Në vendin tonë ka përhapje të gjërë nga Llogaraja në Valbonë, në pjesën qëndrore të vendit. Gjendet në zonën e dushqeve dhe në zonën e ahut në lartësi 600-1500 m mbi nivelin e detit. Gjendet në pyje të thjeshtë si dhe shoqeruar me dushqet, ahun, bredhin, etj. Rritet në klimë malore të butë, pelqen tokat të cekta mbi formacione serpentinash dhe gelqerore. Zhvillohet mirë në tokat e murrme pjore dhe të kafejta. Kerkon dritë, duron thatesirën e tokës dhe atë në atmosfere. Ka vlerë përdorimi si një drurët kryesor të pyjeve të vendit tonë, si një dru i rëndësishëm i për pyllëzimin e tokave të zhveshura të zonës së dushqeve. Mund të përdoret si dru për zbukurim në parqet urban. Masivet me pishë të zeze thujasë në gjithë Shqipërinë janë shfrytëzuar. Shumë sipërfaqe me pishë të zeze, sot janë të zhveshura nga djegja e pyjeve në periudhën 1990-2015.



Pisha e butë (*Pinus pinea* L)

Eshhtë dru i kategorisë I. Trupi rritet arrinë deri 20-25 m lartësi, deri 1.5 m diameter cilindrik përgjithësisht i drejte, jeton 200-250 vjet. Rrënja është më me zhvillim në thellesi po dhe atë anësor. Lëvorja ngjyre të kuqerremet në të erret me shumë luspa. Kurora e druveve është në formë ombrelle. Degët e reja janë të blerta në të verdhë me shume shkelqim. Sythet janë pa rreshirë, në trajtë konike deri 1 cm të gjatë. Gjethet janë halë nga dy sëbashku 10-20 cm të gjata dhe 1.5-2 mm të trasha, me majë joshpuese, në anë kanë dhëmbëzim të imet. Lulet janë njëseksore monoike. Lulet mashkullore janë në formë gathësh të verdhë. Lulet femrore dalin në sythet në kryesisht majen e dgeve, me ngjyrë të kuqe manushaqe. Fruti, është një boçe pa bisht me gjatesi 8-15 cm ka ngjyrë të murrme në të zezë. Boçet piqen në vitin e tretë pas lulëzimit. Farat në gjuhën popullore quhen fistik , janë të ngrenshme, janë 15-20 mm me një flater. Ç’do boçe ka 50-100 fara. Shumezimi behet me farë. Rritja është e madhe sidomos në moshë të re në lartësi. Druri ka ngjyre të




kuqe, është e qendrueshme me shume kanale rreshire, e lehte ne perpunim, elastike, është i lehtë. Kërkesat ekologjike dhe përdorimi: Është lloj tipik i klimes mesdhetare, kerkon shumë dritë dhe nxehtësi. Ka vlerë përdorimi si një drurët kryesor të pyjeve të vendit tonë në zonën e dafines, si një dru i rëndësishëm për pyllëzimin e tokave të zhveshura te zones se ranishteve bregdetare dhe për boçet dhe farat që grumbullohen e perpunohen. Mund të përdoret si dru për zbukurim në parqet urban

Pisha e detit (Pinus pinaster Ait ose P.maritima Mill)

Është dru i kategorisë I. Trupi rritet arrinë deri 40 m lartesi, deri 1 m diameter cilindrik pergjithësisht i drejte ose ne forme shpate, jeton 150-200 vjet. Rrënja është e fuqishme me zhvillim në thellesi po dhe atë anësor. Levorja ngjyre të kuqerremet në të erret me shumë luspa në carje te thella. Kurora e drureve në rini është ne forme piramidale, ndersa më vonë merr shtrirje të crregullt, me shume shkelqim të gjelber të errët. Deget e reja qendrojnë horizontalisht. Sythet janë të mëdhej pa rreshirë, në trajtë konike deri 3-5 cm të gjatë. Gjethet janë halë nga dy sëbashku 10-25 cm te gjata dhe 2 mm të trasha, me majë shpuese, ne anë kanë dhëmbëzim të imet. Lulet janë njëseksore monoike. Lulet mashkullore janë në formë gathësh të verdhë. Lulet femrore dalin në sythet në kryesisht majen e dgeve, me ngjyrë të kuqe manushaqe. Fruti është një boçe pa bisht me gjatesi 10-15 cm ka ngjyrë të murrme në të zezë të zgjatur. Boçet piqën në vitin e dytë pas lulëzimit. Farat janë 4-10 mm me një flater. Shumezimi behet me farë. Ritja është madhe sidomos në moshë të re. Druri ka ngjyre të kuqe, është i qendrueshem, me shume kanale rreshire, i lehte ne perpunim, elastike është i lehtë. Është lloj i klimes mesdhetare deri paramalore, kerkon shumë dritë dhe nxehtësi, por duron dhe temperaturat e uleta deri -20 grade per një kohë të shkurtër. Reziston ngricave më shumë se halorët e tjerë mesdhetar. Në vëndin tonë ka perhapje në ultësirën bregdetare dhe atë paramalore. Mund të përdoret si dru për zbukurim në parqet urban. Druri ka vlerë sidomos në industrinë e celulozes. Rreshira që prodhon është e bollshme dhe me cilesi të lartë.

FAMILJA E SELVIVE përfaqësohet me tre gjini kryesore; Gjinia dëllinjave (Juniperus); Gjinia e



Selvive (Cupressus); Gjinia Tujë

Gjinia dëllinjave (Juniperus) përfaqësohet nga drurë të kategorisë III, pra janë kryesisht shkurre që kanë vlera zbukuruese, vlera për drurin dhe frutat. Në botë në këtë gjini bëjnë pjesë rreth 60 lloje. Në vendin tonë rriten; dëllinja e zezë, dëllinja e kuqe (Juniperus oxycedrus), dëlliqëza (Juniperus sibirica), dëllinja kokërrmadhe (Juniperus macrocarpa), fithësi (Juniperus phoenicea L), bërsheni (Juniperus



foetidissima), venja (Juniperus excelsa) dhe jermësina (Juniperus sabina). Dëllinjtat kanë vlerë si element të biodiversitetit në rezik zhdukje dhe me gjendje të përkeqësuar. Me të vlerësuar janë dëllinja e zezë dhe ajo e kuqe për frutat. Si një lloj i rrallë dhe me një përhapje të kufizuar është venja e cila gjendet vecmas në Prespë dhe në zonën e Zagorisë.

Dëllinja e zezë (Juniperus comunis L). Përshkrimi: Është dru i kategorisë III, ; arrinë lartësi 5-6m, në forme e shkurrje, Degët të drejtuara lart. Gjethet janë hala me një vijë deri 2 cm gjatësi, 1-2 mm të trasha, me majë të mprehta të forta dhe shpuese. Lulet janë njëseksore dioike dhe rrallë herë monoike. Fruti është një bakë e rreme 6-9mm e rrumbullakët me ngjyrë të zezë kur piqet. Farat janë të vogla, trekëndeshe, piqen në vjeshten e vitit të dytë. Frutifikon çdo vit bollshëm. Rritja është e ngadalshme. Druri ka përdorim për orëndi të ndryshëm. Është e përhapur në zonën e dushqeve dhe atë të ahut, rritet në klimën mesdhetare kontinentale tranzitore, në toka të cekta. Është dru dritëdashës, nuk duron hijezimi nga të tjerët. Ka rëndësi si element i diversitetit dhe për frutat të cilët grumbullohen dhe përpunohen për prodhim esence. Në dekadat e fundit, ka ardhur duke u pakësuar nga prerjet dhe zjarret.



Cupressus sempervirens

Gjinia Selvi tek në përfaqësohet me tre lloje, ku me e rëndësishme është:

Selvia ose qiparisi (Cupressus sempervirens)

Përshkrimi: Është dru i kategorisë I, arrinë lartësi deri 35m, me trung të drejtë cilindrik dhe kurore piramidale. Levorja është e murrme e hollë me carje gjatësore. Gjethet janë hala mëllugore (luspore) të kryqëzuara dhe të ngjitura njëra mbi tjetrën, përmbajnë rreshirë. Lulet mashkullore janë në formë gathësh të vegjel ngjyrë të verdhë, lulet femrore kanë ngjyrë të blertë. Fruti është një boce e rrumbullakët me diametër deri 3 cm, me ngjyrë të erret ku piqen rreth 12 fara që piqen në vjeshtë. Rritja është e ngadalshme sidomos në toka të cekta. Jeton

deri 200 vjet, Druri ka vlerë si ajo e pishave, përdoret për orëndi të ndryshëm dhe si lende në ndertime. Është e përhapur në zonën e dafinës kryesisht si dru zbukurues në mjedise të ndryshme. Përdoret si dru zbukurues në parqe dhe në rrugët auto.

Gjinia Tujë, përfaqësohet në vendin tonë me tre lloje që së tepërmi kanë vlera si drure për zbukurim në parqe e mjedise urbane. Vlerësohen për kuroren dhe format që mund t'u jepen gjatë krasitjes, përmendim Tuja (Thuja orientalis)

TEMA MESIMORE NR 4. Bimët pyjore farëveshura, familja shelgore, arnore, meshtenkore

4.1 C'farë janë farëveshurat (Angyespermet)? Janë bimë me farë të veshur, të lindura në një vezore të mbyllur me ane të disa gjetheve karpelare. Ne pjesën me të madhe, farëveshurat kanë lule dyseksore. Organet e riprodhimit kanë pistile të plotë dhe thekë me pjalm. Bimësia e këtij grupimi pergjithësisht gjethet i kanë në formë flete dhe shpesh emertohën "Fletorë".Këta drurë riprodhohen në mënyrë seksuale (farë) dhë në mënyrë vegetative (kalema, lastar, shpatulla, shartime, perpanjë etj). Kjo cilësi shumimi ka mundësuar një numer te madh familjesh e gjinish dhe shume lloje pyjore me rendesi.

NENDEGA E BIMEVE FAREVESHURA (ANGIOSPERMAE)

Nga pikëpamja fitogjenetike bimet farëveshura (angiospermet) janë më të reja se bimët farëshveshura. Gjini të rëndësishme për florën e vëndit tonë janë gjini të tilla si Fagus, Quercus, Salix, Fraxinus, Ulmus, Tilia etj. Areali i fareveshurave eshte shume i gjere, ai shtrihet si ne zonat e ftohta te dy hemisfereve, ashtu edhe ne zonat ekuatoriale, tropikale dhe subtropikale. Angiospermet ndahen ne dy klasa, në varësi me numrin e kotiledoneve te emrionit. Klasa Dicotyledoneae dhe Klasa Monocotyledoneae. Në klasën Dicotyledoneae do të njihemi me nje sërë Rendesh si rendi: Salicales, Juglandes, Fagales, Urticales, Sapindales, Malvales, Oleales.

4.2 FAMILJA SHELGOREVE (Salicaceae)


Përbën familjen e vetme te rendit Salicales dhe ne te perfshihen dy gjini: Salix-Shelg dhe Populus–Plep. Janë drure që kanë gjethe të thjeshta, rënshme, të pajisura me ndajgjethëza. Lulet janë njëseksore, të grumbulluara në levarë. Janë bimë dioike. Fruti është kapsulë që hapet ne 3-4 të ndara. Frutifikojnë në moshe te re, çdo vit dhe bollshëm. Janë bimë që vendosën në stacione të lagëta.

Gjinia Salix – Shelg

Kjo gjini permbledh drurë, shkurre dhe nënshkurre të vogla, të përhapura në të gjithë rruzullin tokësor, por me shpesh në klimën e ftohtë që kalon dhe arealin e plepave.

Shelgu i bardhë (Salix alba) Arrin lartësi 15 m dhe rrallëhere mund të shkojë deri në 25 m. Ka një aftësi të theksuar për të formuara rrënjë ajrore, për gjatë trungut. Ka kërcell të drejtë, kurora është e gjerë e rumbullakosur, e dëgëzuar në menyre te çrregullt, e rrallë dhe mbulon dobët tokën. Lëvorja me ngjyrë të hinjte, me të çara të thella qysh në moshe të re, gjethet me bisht të shkurtër 1 cm, me llapë heshtake të thepisur 5-10 cm gjatësi dhe 1-2 cm në gjesinë më të madhe në gjysmën e poshtme; me buzet të sharruara imet.Eshtë bimë dioike, lulëzon shumë heret në pranverë, në mars-prill, në të njejtën kohë me gjethezimin. Frutifikon cdo vit me bollek. Fruti është nje kapsule e shogët, pa bisht e cila piqet ne maj-qershor. Eshtë pak kërkues ndaj klimës, duron të ftohtin e madh të dimrit dhe ngricat e vonëshme dhe te hershme. Zhvillohet në mënyre të bujshme në tokat aluvionale, pjellore dhe të pasura me lagështi. Tek ne takohet kudo, me tepër gjatë rrjedhjes së lumenjve e përrrenjve, kanaleve, rrugëve të komunikacionit 1200-1300 m lartesi mbi nivelin e detit.

Gjethet jane te shogëta, të ngushta heshtake, 8-15 cm të gjata, nga poshtë të gjelbera deri në të hinjta.




Eshte me origjine nga Irani dhe nga pjesa verilindore e Kinës. Tek ne takohet vetem ne parqe si dru zbukurues. Eshte pak kerkues ndaj lagështires dhe ka vlerë të madhe dekorative. Perdoret shpesh e parqe dhe ne kopshte, sidomos ne afërsi te pellgjeve me ujë, në vende të lagëta, për rreth shatrivanëve.

Plepi i bardhë (*Populus alba L*)

Arrinë 30-35 m lartësi dhe diametër që kalon 1m. Ka rritje shumë të shpejtë. Jeton shumë, shkon deri 300-400 vjet, por pjesa e brëndshme e drurit fillon të kalbet shumë shpejt. Ka sistem rrenjor relativisht të thellë, me rrënje të shumëta anësore. Kurora e gjerë, e rrumbullaket me degezim të fuqishem dhe te çrregullt, shumë i dritësuar. Kërçelli në fillim pak i shtrembër, pastaj i drejtë, cilindrik i trashë, shume i degëzuar. Lëvorja karakteristike e bardhë dhe e lëmuar në rini, me pas formon një ritidom të fortë dhe të ashpër sidomos në bazë. Gjethet me bisht të gjatë, ato të bisqeve të gjatë , vezake të rrumbullakëta me 3-5 vriguj pëllëmbore, me majë të mprehtë, të cungëta deri pothuaj se si zemer në bazë, me push të bardhë në pjesën e poshtme të tyre. Eshtë lloj mesatarisht dritëdashës dhe nxehtësidashës. Nga të gjithë plepat, ky ka më shumë kërkesa për sa i përket tokës, ai rritet mirë në toka të thella të freskëta dhe pjellore tregohet rezistent ndaj përmytjeve por me pak se shelgjet. Nuk duron ujin e qëndrueshëm. Shtrihet në krahinat qëndrore dhe jugore të Evropës, duke filluar nga brigjet e Mesdheut deri në Siberi. Druri me myje me te erret, është i bute dhe homogjen, i lehte por me vlere te paket.

Plepi i eger (*Populus tremula L*)

Arrin zakonisht nje lartesi 20-25 m dhe ne kushte te mira arrin dhe 35 m lartesi nuk i kalon 100 vjet jetë. Ka sistem rrenjor siperfaqesor. Kurora rruzullore, e mbledhur dhe e rralle, e perbere nga dege te shkurtera. Kërçelli eshte i drejtë ne pjesen më të madhe i pastruar nga degët. Lëvorja e lëmuar e bardhëreme si e plepit të bardhë. Gjethet janë pothuaj se të rrumbullakta (3-7 x 3-8) cm në bisqet e rinj dhe (14-19 x 12-13) cm në lastarët dhe pinjollët e rritur mbahen nga nje bisht i gjate 3-6 cm, i shtypur i cili përdridhet dhe e leviz llapen kur fryn edhe nje erë e lehtë. Lulet çelin përpara gjethëzimit nga marsi deri ne maj dhe jane te grupuara ne levare. Fruti eshte nje kapsule e shoget qe piqet ne mbarim te majit, kurse farat perhapen menjehere dhe ne distanca te medha. Druri është i bardhe, i bute homogjen, i lehte, elastik. Dallohet per nje aftesi te madhe ripërteritje. Ka pak kërkes ndaj kushteve stacionale, reziston mjaft mire ashpërsimeve te klimës kontinentale me dimra të gjatë dhe fortë. Në dallim nga plepi i bardhë dhe i zi nuk është lloj tipik i luginës. Druri i plepit të eger, gjen përdorim për prodhimin e lendës se sharruar, të ambalazheve për perdorim të zakonshëm, për shkrepse dhe si dru për djegje dhe për prodhimin e celulozes. Ka vlerë dhe si dru zbukurues në parqe dhe rrugë.




Plepi i zi (Populus nigra L)

Arrinë lartësi 30-37 m, diameter mbi 1 m. Jeton 300-400 vjet, por druri fillon të kalbet në moshen 100 vjeçare. Kërçelli është i drejtë herë herë i çrregullt. Kurora është e gjërë, e rrallë, asimetrike. Në moshë të re ka lëvore të zezë e me me çarje të thella gjatësore. Gjethet me bisht 2-8 cm, kanë formë trekëndore ose rombrike, të gjata (5-7(16) dhe të gjëra 2-6 (8) cm), të gjelbëra të shëndritëshme, me majë të mprehtë me formë pykore në bazë. Fruti kapsule 7-9 mm e gjatë vezake dhe me bisht. Ka rritje të vullshme dhe prodhimtari të lartë. Per sa i përket kushteve ekologjike afrohet me plepin e bardhë. Shtrihet pothuaj se në të gjithë Evropën qendrore e jugore, në Azinë perendimore dhe Afriken veriore. Ka vlerë dhe si dru zbukurues në parqe dhe rrugë.

4.3 FAMILJA E ARROREVE

Arra (Juglans regia L)

Eshtë dru që arrinë 15 -20 m lartësi dhe diameter deri 1.5 m. Ka sistem rrënjor të fuqishëm, me rrënjë anësore që shtrihen në distanca të medha deri në 12-14 m. Ka kërçell të drejtë, cilindrik, me kurorë të mbeldhur, kur rritet në gjendje masivi, të gjere rruzullore dhe me degëzime të shumta kur rritet në gjendje të vetmuar. Levorja për shume kohe mbetet e lemuar me ngjyre argjendi në të hinjte, në moshë të medha ajo fillon të plasarit në menyre gjatesore. Gjethet tekpendore të perbera, deri 35 cm të gjata, me 5-9 (11) gjetheza të perkundrejta, eliptike, asimetrike pothuaj se pa bisht, me buze të plota, lekurore, me maje të mprehte ose të thepet. Eshtë bimë monoike. Fruti është një bërthokël vezake rruzullore (3-5 x 3 cm), me zhguall mishtake të gjelbër, i pasur me taninë dhe që në pjekuri çahet në mënyre të çrregullt, fara është arra në formë vezake me maje të shkurter dhe sipërfaqe të rrudhosur në mënyrë të çrregullt që mbështjellë farën ose tulin e arrës. Arra është shumë i ushqyeshëm, ka shije të këndëshme përmban deri në 70% vaj; përdoret gjërësisht në industrinë ushqimore, në fabrikimin e sapuneve, bojërave, llaqeve dhe në kozmetike.



Frutifikon në mosha të vogëla, 12-15 vjeçare. Druri, është homogjen, i fortë, rezistent, i epushëm, me blanë në ngjyrë gri dhe myje të ngjyrosur bukur në te murrme të errët. Kërkon klimë të butë me amplitude të vogël, temperaturë me dimra relativisht te bute pa ngrica dhe te ftohta te medha. Eshtë kërkues ndaj tokes. Tek ne takohet kudo deri ne 1200 m lartesi mbi nivelin e detit. Mund te konsiderohet si druri me i rëndesishëm në botë, për arsye se rritet shpejt, prodhon nje sasi të madhe frutash, që janë shumë të vlefshëm dhe sidomos për drurin, i cili prodhon rimeson me të bukur nga të gjithë druret e tjerë, shumë të kërkuar janë gjithashtu edhe rrënjët per prodhimin e rimesos. Perdoret per pyllezime dhe si dru në parqe.

4.4. FAMILJA MESHTEKNORE. Në vendin tonë gjenden 5 gjini, nga 6 gjini të kësaj familje që gjenden në botë. Gjinia e mështeknavë, e verrinjëve, e shkozës, e mëllezës dhe e lajthive. Gjinia e meshteknës përfaqësohet tek ne, me një lloj.

Mështekna (Betula verrucosa)

Për nga madhësia, i përket kategorisë II. Lëvorja është e bardhë, e lëmuar. Degëzat janë të holla të shogëta me pika të bardha e të varura. Gjethet janë me bisht 2-3 cm në trajtë trekendore rreth 5 cm të gjata, me majë, dyfish të dhëmbëzuara. Lulet janë njëseksore monoike. Ato mashkullore janë cilindrike, pak të përkulura qëndrojnë të varura dy-tre se bashku, ato femërore dalin sëbashku me gjethet janë tre here më të vogla se ato mashkullore. Frutat janë bocëza 1 cm te trashë te cilat sapo piqen leshojne fara qe janë me dy krahë. Fuqia mbirëse 20-30%. Ka vlerë si lloj për pyllezime në zonat e larta malore, ku mbillet dhe pisha e zezë.

Gjinia e verrinjëve, përfaqësohet tek ne me dy lloje kryesore: Verriu i zi (*Alnus glutinosa*); Verriu i bardhë (*Alnus incana*)

Verriu i zi (Alnus glutinosa)

Për nga madhësia, i përket kategorisë II. Rrënjëzimi është boshtor dhe anesor. Trupi rritet i drejtë me kurorë të ngushtë. Lëvorja është e murrme, e blerte, më vonë në hiri , me çarje të thella. Degëzat janë të




holla të shogta me pika të bardha e të varura. Gjethet janë me bisht 2 cm në trajtë rrethore rreth 5-9 cm të gjata, me majë. Lulet janë njëseksore monoike në formë gathësh. Ato mashkullore janë qëndrojnë të varura dy-tre sëbashku, ato femërore dalin sëbashku me gjethet janë tre herë më të vogla se ato mashkullore. Rritet shumë shpejt, llastaron fuqishëm deri në 60 vjet, rrallë jeton deri 100 vjet. Druja është e bardhë, pastaj bëhet e kuqerremët, pa zemër, elastike. Në mjedise më lagështi qëndron më shumë se në mjedise të hapura.. Nuk rritet mirë në tokat argjilore dhe në formacione gëlqerore. Eshtë

dru dritëdashës. Ka vlerë si lloj për pyllëzime në zonat kënetore dhe afër lumenjeve.

TEMA MESIMORE NR.5 Bimët pyjore farëveshura. familja: ahore, vidhore, trendafilore

5.1. FAMILJA AHORE, përfshinë rreth 900 lloje drurësh dhe shkurresh të shtrira nga klima e ngrohte deri ato të temperuara në hemisferin verior. Në këtë familja kanë rendësi si drurë pyjor, përfaqësuesit të



tre gjinive që gjenden dhe në vendin tonë. Gjinia e Ahut (*Fagus* L) gjinia e Dushqeve (*Quercus*) dhe Gështenjës (*Castanea* L)

Ahu (*Fagus silvatica* L)

Dru i klasës I, arrin lartësi 30-40 m dhe diameter mbi 1-1.5 m. Ka sistem rrënjor boshtor me degezime të shumta duke krijuar një mbërthim të mirë në tokë. Kërçelli i drurit të rritur në masive të dendura është shumë i drejtë, cilindrik dhe i pastruar nga degët në pjesën më të madhe. Kurora në fillim konike, pastaj e gjerë e mbledhur në majë të kërçellit në grumbujt të dendur. Levorja është e lemuar e holle, në ngjyrë gri, shpesh me njolla të medha. Gjethet janë të këmbyera, vezake ose eliptike (4-10 cm të gjata dhe 3-7cm të gjëra), me majë të mprehte, me buze të plota ose rrallëhere të dhëmbëzuara dhe pak të valëzuara, me ngjyrë të gjelbër të errët nga ana e sipërme dhe më të hapur nga pjesa e poshtme. Është bimë monoike, lulet çelin në prill-maj. Frutat janë akene me tre qoshe, të murrme, të kuqërremta 1-1.5 cm të gjata, të mbyllur tërësisht në një pështjellesë frutore drunore në formë kupe (zhguall) në ngjyrë ndryshku, e pajisur me zgjatime. Druri ka ngjyrë të bardhë të kuqërremte, me rreze palcore të dallueshme, rrathet vjetore pak të dallueshëm, është pa myje, i rendë dhe i fortë, i çashëm, me zatarisht elastik, kalbet lehtë, tek druret e moshave të mëdha shfaqet prania e zemres së kuqe e cila ka formën e një njolle të çregullt në qendër të drurit. Është lloj i klimes oqeanike, me luhajtje termike vjetore pak të theksuar, është kërkuar ndaj lageshtires sidomos asaj atmosferike, preferon stacionet e fresketa malore, me të pakten 1000 mm rreshje vjetore, të mbrotjura nga ererat e ftohta. Është një lloj shumë i ndjeshëm ndaj të ftohtit të madh sidomos ndaj ngricave të vonshme. Në Europën veriperendimore ahu, është lloj fushor dhe kodrinor, ndërsa në jug dhe juglindje ai behet lloj ekskluziv malor. Formon grumbuj të

thjeshte ose të perzier, me shtrirje të gjërë në krahinat e Euorpës qendrore. Tek ne është ndër llojet më të përhapur dhe më të rëndësishëm të fondit tonë pyjor. Shtrihet kryesisht në shpatet malore, duke mos u takuar pothuajse asnjehere ne rrafshje. Masivet me të mëdhenj të ahut jane vendosur ne krahinen malore qendrore e veriore dhe ne disa pika ne menyre fragmentare, ne ate jugore. Në pjesën më të madhe, ai takohet ne lartesi 900-1800 (2000) m mbi nivelin e detit. Në pergjithësi formon pyje të thjeshtë, ndersa në raste te rralla, ne kufinjte e arelait ai perzihet me bredhin e bardhe, panjen e malit, hormoqin, rrobulin, arnenin e ndonje tjeter. Nga distilimi i thate perftohet acid acetik, katran dhe prodhime te tjera kimike. Nga ehujt nxirret nje lloj vaji qe perdoret ne industri per prodhimin e sapuneve.

Gështenja (*Castanea sativa* Mill)

Eshte dru i klasës II, arrinë zakonisht 10-20 m lartësi dhe 1-2 m diameter. Sistemi rrënjor është i fuqishem por pak zhvilluar ne thellesi. Kercelli zakonisht i drejte dhe i trashe me pamje madheshtore, me kurore mjaft të zhvilluar, të gjere, të shtrire dhe të rumbullakosur. Lëvorja është e lëmuar e shëndritshme, në ngjyre te murrme ne te kuqerremte, mbas moshes 25 vjeçare levorje formon nje ritidom mjaft ngjeshur. Gjethet jane te thjeshta, të kembyera, te renshme, me bisht te shkurter 15-25mm, të pajisura me ndajgjetheza vizake qe bien heret, me llapen eliptike heshtake (12-20 cm gjatesi dhe 3-6 cm gjeresi), buzet me dhembe, me ngjyre te gjelbert te erret, te shogeta, te ndritshme nga siper dhe me te zbehta nga poshte. Eshtë bime monoike, lulet mashkullore janë lavare. Eshtë bimë mjaltese me cilesi të larte. Fruti eshte aken me 2-3 cm diameter, më 2-3 kokrra brenda nje kupe sferike afersisht drunore e mbuluar me gjemba te gjate. Druri, është mesatarisht i rende, i ngjeshur, elastik, myje te gjere, ne ngjyre te murrme, blane te bardhe ne te verdhe, i pasur ne tanine, punohet dhe cahet lehte.. Tek ne masivet me te medhenj te gështenjes takohen e Tropojë, Kukës, Gurakuq te Librazhdit, Zervaske të Pogradecit, Shllak të Shkodres, Dukagjin, etj. ne nje lartesi 400-800 m mbi nivelin e detit. Paraqet interes te veçante si per frutin ashtu edhe per drurin. Fruti ka vlera të mëdha ushqyese, permban ne sasira te medha amidon, glukoze, saharoze, vitamina. Nga kokërrat prodhohet miell, alkool, sheqer dhe vaj. Druri perdoret ne fabrikimin e mobiljeve, per voza, ne industrine e letres, per prodhimin e celulozes, druri dhe levorja jane te pasura me tanine dhe perdoren per regjien e lekureve. Perdoret në pyllëzime dhe rralle si dru per zbukurim ne parqe dhe rruge


Gjini e Dushqeve (*Quercus L.*) përmbledh një numër të madh drurësh pyjor. Të përhapur anë e mbanë globit, nga malet e Amerikës Qendrore deri në Kolumbi dhe nga Azia deri në Arkipelagun Malez. Nga 250-300 speciet e dushqeve që zhvillohen në botë, në vendin tonë takohen 10-12 lloje. Zona e dushkajave ndodhet ndërmjet asaj të pyjeve e shkurretave mesdhetare dhe asaj të ahishteve. Ajo shtrihet në 400-1250 m mbi nivelin e detit (400-800 m në Shqipërinë e Veriut, 550-1000 m në atë të Mesme dhe 800-1250 m në atë Juglindore e Jugore. Kjo zonë ka një gjerësi mesatare prej 500 m (në Pukë e Mirditë rreth 300 m, ndërsa në luginën e Shkumbinit dhe atë të Devollit rreth 650 m). Dushkajat janë vendosur kryesisht në shpate me pjerrësi 5-20°.

Bunga (*Quercus petraea* Liebl.)

Dru i kategorise II-I mund të arrijë lartësine deri 40 m, jeton 300-400 vjet. Sistemin rrënjor boshtor hyn thellë në tokë. Trungu i drejtë, me lëvore në fillim të lëmuar e të ndritshme, më vonë çahet, merr ngjyrë të murrme në të errët. Bisqet të shogëta, me ngjyrë të blertë të errët, me pak lenticela, me sytha konikë. Gjethet me bisht 10-25 mm të gjatë, të rënshme, të blerta, vezake të përmbysura. Lulëzon në prill-maj dhe i pjek frytat në shtator-tetor të po atij viti. Frutat (lëndet) qëndrojnë 1-5 së bashku. Në një kg gjenden 250-350 lënde. Fuqia mugulluese arrin deri 60 % dhe e ruan për 4-5 muaj. Frytifikon çdo 4-6 vjet. Rritja në fillim e ngadaltë, ndërsa pas moshës 10 vjeçare shpejtohet. Shumëzohet me farë, me mbjellje direkte apo me fidanë. Lastaron mire. Gjendet më shpesh në Shqipërinë Veriore dhe në atë të Mesme. Formon bungishte të thjeshta ose të përziera. Eshte lloji i tipit mezofil dhe me kërkesa. Kërkon zona me rreshje të pasura, terrene të freskëta e pjellore, të kulluara. Eshtë nga dushqet më të përhapur në vendin tonë. Takohet kudo, deri 1300 m mbi nivelin e detit, si në Tropojë, Kukës, Pukë, Kthellë, Mat, Krujë, Krrabë, Çermenikë, Dumre, Librazhd, Gorë, Sulovë, Skrapar, Përmet e gjetiu. Eshtë dru me vlerë të lartë, që gjen përdorime të gjithanshme për lëndet me vlerë në ushqimin e derrave dhe për lëvoren e pasur me taninë. Kërkon vemendje të madhe për ripërtëritjen, përhapjen në zonat përkatëse dhe mirëmbajtjen e pyjeve me bungë.

Shparthi (*Quercus frainetto* Ten.)

Druri i klases I, arrinë 30-40 m i lartë me trup të drejte, i ngjashem me atë të bungës. Levorja formon nje kore te holle ne forme luspash. Kurora e gjere, e pasur me gjethe. Bisqe te trasha, me push me lenticele, me sythe shume te medhenj, vezake, (sythet i ka me te medhenj se te cdo dushku tjetër). Gjethet bien vone ne vjeshte, te gjata rreth 15-18 cm, te gjera 6-12 cm, me gjinj te thelle e pothuaj paralele, perfundi me vesheza, perposh me push. Lulezon ne Prill-Maj dhe pjek frutat ne Tetor. Lendet i ka të trasha, pothuaj pa bisht qendrojne 2-8 se bashku. Gishtja (kupa) mbulon vetem 1/3 e gjatesisë se lendës. Rritja me e ngadalte se ajo e bunges, e qarrit dhe e rrenjes. Jeton me pak se bunga. Druja ka cilesi te mire, të ngjashme me te bunges por ka blane me te gjere, e pershtatëshme per mobilje, për derrasa, per vegla bujqesore, etj. Tek ne ndodhet i perhapur ne zonen e dafines dhe te geshtenjes.



Qarri (*Quercus cerris* L.)

Dru i klasës II, arrinë lartësinë 25-30 m dhe diametrin rreth 1m. Rritja e mirë në vitet e para, ja kalon dushqeve të tjerë. Sistemi rrënjor boshtor, i thellë. Lëvorja e murrme në të kuqërreme me çarje të thella gjatësore dhe transversale. Bisqet gri në majë me push. Sythet me mëlluga në trajtë fijesh. Gjethet të rënshme me ndajgjethe të qëndrueshme, llapa 5-10 (18) cm e gjatë 3-5 (8) cm e gjerë e vrigëlluar apo pendore. Lulëzon ne prill-maj dhe frutat i pjek ne tetorin e vitit të dyte. Frutat i ka gati pa bisht, 1-4 sëbashku. Lënda vjen si e shtypur, ne maje ka nje thumb. Lastaron bollshem. Druja ka ngjyre te murrme ne te kuqerreme, e rende me rrathe vjetore te ndare mire, me rreze modulare me te dukëshme se sa bunga. Druja sherben per derrasa. Vlerësohet shume si dru zjarri. Gjendet gati gjithkund neper pyje dushkajash apo fletorësh te tjere ne zonen e geshtenjes dhe te dafines madje, dhe ne nenazonen e ngrohte. Rritet mire ne toka me natyre silicore dhe argjirore dhe ne ato te kuqerreme te dekalCIFIKUARA. Ju shmanget tokave gelqerore ne te cilat gjenden shpesh ilqja dhe bungbuta. Takohet me shumicë si në fusha e kodra dhe në male, 1200 - 1400 m mbi nivelin e detit. Më shumë gjëndet në Kukës, Peshkopi, Mat, Krujë, Çermenikë, Dumre, Sulovë, Gorë, Skrapar, Përmet, Mallakastër, etj.


Bungëbuta (*Quercus pubescens*.)

Eshtë dru i klasës II, arrinë 18-20 m e lartësi. Jeton 300-400 vjet, por mund të shkojë rallë edhe 800- 1000 vjet Lëvorja e drurëve të moçëm është e çarë, pllaka- pllaka, pak a shumë të drejta. Gjethet janë 6-12 cm të gjata e 4-6 cm të gjera, me fund të rrumbullakët, me 5-7 vriguj; në pranverë me push në të dy faqet. Lëndet janë më të vogla e më të holla se të bungës (deri 2 cm të gjata) me push të imët dhe piqen në tetor. Eshtë

nga dushqet më të përhapur e më të shumtë të vendit tonë. Takohet kudo, por më shumë në pllajat deri 1100 m mbi nivelin e detit. Gjetet më shumë në Kthellë, rrëzë maleve Milot - Krujë - Tiranë, në kodrinat e Shijakut, Kavajës, Peqinit e Vrapit, në Çermenikë, Sulovë, Tomoricë, Opar, Gorë, Skrapar, Përmet, Mallakastër, Tepelenë etj. Përveç Ballkanit, gjendet në Itali e Francën e Jugut, në Evropën Qëndrore, etj. Mjaftohet me më pak lagështi ajri e toke se bunga, ndërsa për dritë renditet ndërmjet bungës e shpardhit. Takohet në pyje të përzier me qarr, bungë, shparth, shkozë e krekëz. Leshon lastarë sa herë që pritet. Qeveriset si cungishte për dru zjarri, cungo-trungishte kur perdoret per gjeth dhe shumë rrallë si trungishte për lëndë. Përdoret për lëndë ndertim, bishta vegla bujqësore që kërkojnë dru të fortë, si dhe për punime detare, për shtylla, pilota, traversa, etj. Është shumë i mirë për dru zjarri dhe qymyr. Lëvorja përmban 10-12 % taninë. Gjethet përdoren si ushqim për bagëtitë. Vlen të mbillet për ripyllezimin e vendeve me gurë e të thata, për hijezimin e rrugëve malore dhe për të zbukuruar parqet.

Bulgri (*Quercus trojana*.)


Dru i klasës II, arrinë 20-25 m i lartë dhe 1-1.5 m i trashë. Lëvoren e ka të murrme dhe me të çara gjatësore, si të qarrit. Degët e reja janë të kuqërreme të errëta (prandaj thirret edhe qarr i kuq). Gjethet, me bisht të shkurtër, ovale, i ka 4-7 cm të gjata dhe 2.5-4 cm të gjera, anës të dhëmbëzuara si të gështenjës. Lulet çelin në prill -maj. Lëndet, që i ka në zhguall më të madh se të qarrit, janë 2.5-4.5 cm të gjata dhe 2-2.5 cm të trasha, me një si thumb në majë, piqen në nëntor. Gjendet në krahinat me klimë mesdhetare, deri 800 m mbi nivelin e detit, por më shumë gjendet ndërmjet 400 e 600 m. Është më hijedashës se bunga, në klimë e toka të përshtatshme formon pyje të thjeshtë e të bukur. Do ajër e dritë. U qëndron erërave, por jo dhe të ftohtave të mëdha. Është shumë i ndjeshëm ndaj lagështirës së tokës. Në toka të thata, me gurë e të rrahura nga erërat rritet i përzier me bungëbutën, gorricën, ngasjen, kulumbrinë, frashërin e bardhë etj. Përtërihet lehtë me farë dhe me lastarët e shumtë që nxjerr.. Është shumë i mirë për dru zjarri dhe qymyr. Lëvorja përmban lëndë regjëse. Gjethi i bulgri hahet me shije nga dhitë gjatë dimrit. Me që rritet mirë në toka gëlqerore dhe me që ka rritje të shpejtë, vlen të mbillet në rajonet jugore për dru zjarri e lëndë.



5.2 FAMILJA E VIDHORE

Në botë permbledh disa drurë dhe shkurre. Në vendin tonë ka dy gjini: Vidhi dhe Carac. Gjinia vidh perfaqë sohet me tre drure: vidhi i malit, Hithesi (*Ulmus montana*); vidhi i fushes (*Ulmus campestris*); bulini (*Ulmus leavis*)

Vidhi i malit (*Ulmus Montana*) Për nga madhësia, i përket kategorisë II-I. Rrënjëzimi është boshtor



dhe ansor. Lëvorja është e murrme, e blertë më vonë krijon çarje të thella. Degëzat me ngjyrë gështënjë me qime të shkurtëra. Gjethet janë në trajtë eliptike rreth 8-15 cm të gjata, me majë, dyfish të dhëmbëzuara. Lulet janë fashikuj pa bisht. Frutat janë shojza eliptike me të çara, piqen në qershor. Rritet shpejt deri në moshën 40-60 vjet, llastaron fuqishëm nga cungru, jeton mbi 100 vjet. Druja është e verdhë dhe pastaj merr ngjyrë të kuqremët, pak e qendrushme dhe elastike. Në vendin tonë gjendet kryesisht në zonën veriore deri në zonën qendrore. Gjendet në grumbuj pyjor të përzier me ahun Kerkesat ekologjike. Pëlqen klimë medhetare kontinentale sidomos në zonën e ahut. Rritet në toka të thella pak lagëta e të freskëta. Ka vlerë si lloj për pyllëzime në zonat malore dhe në parqe dhe zona të gjelbra si dru zbukurues.


5.3 FAMILJA E TRËNDAFILOREVE

Në botë në këtë familje përfshihen rreth 3250 lloje drure kryesisht frutor, bimë mjekësore industriale barishtore. Në vendin tonë përfaqësohet me disa gjini dhe shumë lloje por që nuk krijojnë pyje. Kanë vlerë si elemente të biodiversitetit dhe për frytat që prodhojnë. Lulet janë dyseksore të rregullta. Frutet janë berthokla, rrushqe, aken, kapsula, dhe forma të tjera. Përmendim disa gjini me llojet me përfaqësuese. **Gjinia dardhë** me llojin gorica (*Pyrus amygdaliformis*), dardha e eger (*Pyrus comunis*).



Gjinia mollë me përfaqësuese, molla e eger (*Malus silvestris*). **Gjinia vadhe** me përfaqësues vadhje e egër (*Sorbus occuparia*), vadhja (*Sorbus domestica*), vadhëvicja (*Sorbus verinalis*); vadhëvicja e bardhë (*Sorbus aria*). **Gjinia murriz** përfshinë kryesisht shkurre. Në vendin tonë rriten disa lloje

murizesh si; Murrizi njëbërthamesh (*Crataegus monogyna* L), Murrizi dybërthamesh (*Crataegus oxyacantha* L), Murrizi pesëbërthamesh (*Crataegus pentagyna* L), Murrizi I zi (*Crataegus nigra* L), Murrizi i butë (*Crataegus orientalis* L).




Gjinia Rubus me perfaqesues Mjedra (*Rubus ideaus* L); Manaferra (*Robus ulmifolius*) **Gjinia trendafil** ne vendin tonë perfaqesohet me rreth 30 lloje kryesisht shkurre. Me e perhapur si shkurre ne pyje dhe kullota janeeshte Trendafil i eger (*Rosa canina*)



TEMA MESIMORE NR. 6 Bimët pyjore farëveshura. familja: bishtajore, panjore, blinore

6.1 Ç'farë janë dhe kush përfshihet tek familja e bishtajorëve?

Bishtajore, familje bimësh, e cila përmbledh barishte, shkurre ose drurë, që e kanë frytin bishtajë. Në botë përfshinë rreth 12000 lloje. Nga familja bishtajore tek ne ka disa gjini ku rritën një numer i madh bimesh si dru dhe shkurre; Gjinia Mimosë (Acacia perfaqësohet me *A. dealbata*); Gjinia Albicje (Albizzia Durrëz perfaqësohet me *A. julibrissin*), Gjinia Lofatë (Cercis perfaqësohet me *C. siliquastrum*), Gjinia Xhixhibanoz (Ceratonia perfaqësohet me *C. siliqua*); Gjinia Gledicja (Gleditschia perfaqësohet me *G. triacanthos*); Gjinia Parkinsonie (Parkinsonia perfaqësohet me *P. aculeata* L); Gjinia Cezalpine (Caesapinia perfaqësohet me *C. gillesii*); Gjinia Sofore (Sophora perfaqësohet me *S. japonica*), Gjinia Qelbesi (Anagyris perfaqësohet me *A. geotida*); Gjinia Ajdes (Laburnum perfaqësohet me *L. alpinum*), Gjinia Vjexhes (Cytisus perfaqësohet me *C. hirsutus*); Gjinia Gjineshter (Genista perfaqësohet me *G. tinctoria*); Gjinia Xane (Spartium përfaqësohet me *S. junceum* L); Gjinia Robinie (Robinia përfaqësohet me *R. pseudoacacia* L); Gjinia Visteria përfaqësohet me *V. sinensis*); Gjinia Fishekarte (Colutea përfaqësohet me *C. arborescens* L) ; Gjinia Skerbull (Amorpha përfaqësohet me *A. fruticosa* L)





6.2 Ç'farë janë dhe kush përfshihet tek familja panjore?



Në botë përfshinë rreth 150 lloje drurësh e shkurresh, së shumti në hemisferën veriore. Në vëndin tonë gjendet gjinia panjë (*Acer*) që përfaqësohet me disa lloje pyjore me vlera për drurin dhe si element të biodiversitetit. Keto lloje nuk formojne grumbuj pyjor të vecantë por së shumti janë të perzier me fletorë dhe halorë e tjere. Disa lloje kanë vlera zbukuruese dhe përdorën në parqe dhe gjëlberim të mjediseve të ndryshme. Lloje kryesore janë; Panja e malit (*Acer pseudoplatanus L*); Panja fletgjerë (*Acer obtusatum L*); Panja fletëmprehtë (*Acer platanoides*); Krekëza fletëmadhe (*Acer campestre L*); Krekëza fletëvogel (*Acer monspessulanum L*); Ulëza (*Acer tataricum L*); Panja fletefrashër (*Acer negundo L*); Panja e bute (*Acer hyrcanum L*) panja e Heldreichi (*Acer heldreichii L*)

6.3 Ç'farë janë dhe kush përfshihet tek familja blinore?

Kjo familje tek ne perfaqësohet me një gjini (*Tilia*) ku rriten lloje me vlere si drure pyjor dhe zbukurues. Bliri fletëvogël (*Tilia cordata*); Bliri fletëgjërë (*Tilia platyphyllos Scop.*); Bliri fletargjent (*Tilia tomentosa*)




TEMA MESIMORE NR. 7 Bimët pyjore farëveshura, familja ullinjore dhe të tjera

7.1. Çfarë janë dhe kush përfshihet tek familja ullinjore?

Kjo familje përfshinë rreth 22 gjini me afro 500 drure dhe shkurre me rendesi ushqimore; pyjore dhe zbukurimi . Në vëndin tonë kanë rëndësi si drurë pyjor gjinitë si më poshtë:

1 Gjinia Frashër që përfaqësohet me tre lloje: Frasheri bardhë (*Fraxinus ornus* L); Frashëri i zi (*Fraxinus excelsior*) dhe Frashëri fletëngushtë (*Fraxinus angustifolia*).



2. Gjinia Voshter që përfaqësohet me Voshtra kineze (*Ligustrum sinense*), Voshtra gjethenditeshme (*Ligustrum lucidum*), Gjipësi (*Ligustrum vulgare*); Janë drure zbukurues ne parqe dhe zona të gjelbra

3. Gjinia Krifshë që përfaqësohet me; Krifsha fletengushtë (*Phillyrea angustifolia*); Krifsha e ndermjeme (*Phillyrea media*), Krifsha fletëgjërë (*Phillyrea latifolia*)

4. Gjinia Argavan (Jargavan) tek ne perfaqesohet me një lloj Argavani– Jargavani (*Syringa vulgaris*). Me vlera për lulet, gjethet dhe formave te veçanta si dru zbukurues ne parqe e lulishte.



7.2 Familje dhe gjini tjera të rëndësishme ku përfaqësohen më së shumti nga drurë pyjor dhe zbukurues dhe me vlera mjekësorë.

FAMILJA MANJLORE, Gjinia Manjole (Magnolia); FAMILJA DAFINORE (Lauraceae), Gjinia Dafine (Laurus), Gjinia Kamfora (Cinnamomum); FAMILJA RRAPORE (Platanaceae), Gjinia Rrap (Platanus); FAMILJA PITOSPORORE (Pittosporaceae), Gjinia Pitospore (Pittosporum); FAMILJA MELIORE (Meliaceae) Gjinia Tespi (Melia); FAMILJA SHQEMORE (Anacardiaceae) Gjinia Shqeme (Rhus), Gjinia Cermedell (Cotinus), Gjinia Bafer (Pistacia), Gjinia Druri i piperit (Schinus); FAMILJA GESHTENJAT E EGRA (Hippocastanaceae) Gjinia Geshtenja e egër (Hippocastanum); Familja Ashore (Aquifoliaceae); Familja Bushore (Buxaceae) Gjinia Bushi (Buxus) Familja Pjerzore (Rhamnaceae) Gjinia Drize (Paliurus), Gjinia Pjerze (Rhamnus), Gjinia Zogel (Frangula) Familja Hadhiore (Vitaceae) Familja Hynapore (Elaeagnaceae); Familja Myrtacea (Mersinore); Familja Punicaceae (shegore); Familja Cornaceae (thanore)






Buxus sempervirens



Rhamnus fragula



Paliurus spina



Platanus orientalis



Pittosporum tobira



Melia azedarach

TEMA MESIMORE NR. 8 Bimet mjekesore e industriale

8.1 Përhapja dhe rëndësia e bimëve mjekësore.

Në vëndin tonë rritet rreth 3200 lloje bimesh, rreth 10% e florës natyrore janë bimë mjekësore dhe aromatike, nga të cilat 90% rriten në gjendje të egër dhe 10% janë të kultivuara. Ka shumë rëndësi njohja e tyre për të realizuar me sukses mbledhja, grumbullimi dhe tregtimi i tyre. Ato luajnë një rol të konsiderueshëm në



sigurimin e të ardhurave për banorët e zonave rurale në veçanti në gjithë vëndin. Më të rëndësishme ndër bimët mjekësore e aromatike janë: sherbela, timusi, trumza, bliri, dafina, dëllinja e zeze, gjineshtra, mështekna, trëndafili i egër, si dhe një numër i madh bimesh barishtore njëvjeçare. Sot numri më i madh i këtyre bimëve, janë produkte që grumbullohen për eksport dhe në sasi të pakët për përdorim në vënd.

8.2 Vjelja, tharja

Vjelja e pjesëve të ndryshme të bimëve bëhet thuajse gjatë gjithë vitit. Edhe në dimër, po të jenë të favorshme kushtet klimatike, mund të bëhet vjelja e rrënjëve, rizomave, bulbeve, lëvoreve, etj. Për t'u arritur në ndihmë grumbulluesve të bimëve mjekësore dhe aromatike kemi hartuar kalendarin e mbledhjes së këtyre bimëve, përshtatur kushteve të vëndit tonë.

Ja disa këshilla/udhëzime praktike për vjeljen e pjesëve të ndryshme të bimës:

a) Rrënjët. Mblidhen pothuaj në periudhën e qetësisë së bimës, kur kanë akumuluar lëndët që do të shërbejnë për fillimin e vegjetacionit. Në kushtet tona periudha e qetësisë së bimës fillon nga fundi i verës dhe mbaron nga fundi i dimrit. Pra, vjelja bëhet në vjeshtë dhe në dimër (nuk bëhet në ngrica ose kur toka është e mbuluar me borë). Në përgjithësi, rrënjët e bimëve njëvjeçare vilen pak përpara lulëzimit; dyvjeçaret dhe shumëvjeçaret në vjeshtë, pasi t'u kenë rënë gjethet dhe të jetë tharë kërcelli, me përjashtim të disa rrënjëve, si psh, të beladonës, etj.,

b) Gjethet. Zakonisht vilen menjëherë pas lulëzimit të bimës ose kur ajo bëhet gati të lulëzojë. Por, ky rregull ka përjashtime (Helmarina dhe tatulla, psh, kur fillojnë të lulëzojnë, kanë pak gjethet dhe lëndë aktive). Vjelja bëhet gjatë lulëzimit dhe vazhdon për disa muaj. Gjatë lulëzimit vilen edhe gjethet e mëllagës (*M. silvestris*) dhe të lulekambanës. Në vëndin tonë, gjethet e sherbelës (*S. officinalis*) për eksporti, vilen gjithmonë pas lulëzimit, sepse gjatë lulëzimit ato përmbajnë shumë ujë dhe pas tharjes paraqiten zakonisht shumë të holla, të fishkura dhe nuk kanë ngjyrën e tyre të bukur, karakteristike, siç e kanë gjethet e vjela pas lulëzimit. Për qëllime industriale gjethet mund të vilen para e pas lulëzimit, bilë deri nga fundi i dhjetorit, nëse nuk ka ngrica.

c) Lulet. Mblidhen sapo të kenë çelur ose më parë se të çelin plotësisht. Ka edhe bimë (trëndafili,

shtogu, bliri, etj.) lulet e të cilave duhet të mblidhen gjysmë të çelura – kur janë në gonxhe – sepse ato më vonë çelin vetvetiu. Lulet e shtogut, të blirit, të murrizit, etj., çelin plotësisht gjatë tharjes së tyre. Mbledhja preferohet të bëhet në mëngjes, në kohë të thatë, kur është larguar vesa.

ç) Majat e lulëzuara. Vilet gjithë pjesa mbitokësore e palulëzuar e karafilit të egër, etj., ose kur lulet e zhumbicës, lulebalsanit, kinëfushës, etj., fillojnë të lulëzojnë. Në përgjithësi, vjelja e majave të lulëzuara bëhet përpara se bima të ketë lulëzuar plotësisht, sepse çelja e luleve të tyre bëhet gjatë tharjes.

d) Frytat. Mlidhen kur janë sa më të pjekura. Por, kjo ndryshon nga një bimë te tjetra. Frytat mishatake, nëse do të përdoren të freskëta, mblidhen kur janë të pjekura mirë dhe përmbajnë lëng. Ato të dëllinjës e dafinës duhet të vilen të pjekura mirë. Farat vilen kur janë të pjekura dhe nuk duhet të pritet që të bien vetë në tokë.

e) Lëvoret. Mblidhen nga vjeshta në pranverë, zakonisht preferohet fillimi i pranverës, kur bima është në aktivitet të plotë. Sa më e vjetër të jetë lëvorja, aq më shumë vlerësohet cilësia e saj. Lëvoret mblidhen nga degët 2 – 3 vjeçare të drurëve të shëndoshë. Zakonisht mblidhen nga drurë as shumë të rinj, as shumë të vjetër. Përqark trupit ose degëve të bimës bëhet një prerje unazore, deri në dru, në një farë largësie nga njëra – tjetra prej 10 – 20 cm. Midis këtyre prerjeve bëhen dhe dy prerje horizontale. Lëvoret hiqen me thikë.

f) Qepujkat Vilen pothuaj në periudhën e qetësisë; mund të vilen në çdo moshë, kur janë të zhvilluara mirë. Por, megjithatë, ka edhe disa përjashtime. Kështu, psh, qepa e detit vilet në moshën 4 – 6 vjeçare dhe në këtë moshë nuk peshon më shumë se 500 – 600 g. Vjelja e qepës së detit tek ne bëhet kur i thahen gjethet, nga fundi i qershorit deri me 15 shtator. Xhërrokulli vilet nga mbarimi i verës, përpara lulëzimit.

Tharja e bimëve, mjekësore dhe aromatike është një veprim shumë delikat, por i domosdoshëm, për të siguruar ruajtjen/konservimin e tyre. Ky veprim ka për qëllim:

a) T'u heqë bimëve ujin, që përmbajnë indet e tyre.

b) Mbrojtjen nga veprimi i disa mikroorganizmave të vendosura në trupin e tyre para tharjes.

c) Ndalimin e veprimit të fermenteve që përmbajnë, të cilat, pas vjeljes, për njëfarë kohe vazhdojnë të lozin rolin e tyre fiziologjik.

a) Tharja në ajër. Kjo mënyrë ka shërbyer dhe shërben akoma për tharjen e një pjese të madhe të bimëve mjekësore dhe aromatike. Sipas kësaj mënyre, tharja mund të bëhet në koçekët e misrit, në hangare, në plevica ose midis dy gjerdheve a mureve të mbuluar nga sipër me çati, me beze, me llamarinë, me kallam, me kashtë, etj. Kjo mënyrë tharjeje jep rezultate të mira dhe zbatohet gjerësisht në vendin tonë.

b) Tharja në diell. Për këtë lloj tharjeje ka mendime të kundërta, sidomos për lulet e gjethet, pasi qëndrimi i bimëve për një kohë të gjatë në diell, i çngjyros ato, ul vlerat tregtare dhe pjesërisht lëndët aktive të tyre. Por, sipas provave tona, gjethet e helmarinës, etj., nuk patën diferenca të dukshme gjatë tharjes në hije dhe në diell. Po ashtu, nga eksperimentet e kryera në vendin tonë, del se tharja e kamomilit në raste të jashtëzakonshme mund të bëhet në diell. Ndërkohë, tharja e farave, frytave, lëkurëve, rrënjëve, rizomave e pjesëve të tjera nëntokësore mund të bëhet në diell.


c) Tharja e pjesëshme në diell. Sipas disa autorëve, lulet dhe gjethet mund të lihen në diell për disa orë, me qëllim që qelizat të humbasin një pjesë të ujit dhe të marrin faqe para se të çohen për t'u tharë në hije. Kjo mënyrë tharjeje krijon mundësi, nga nan tjetër, që po ato lokale të shërbejnë për të tharë një sasi më të madhe prodhimi. Edhe humbja e ngjyrës gjatë qëndrimit në diell për pak orë, është pothuajse e pandjeshme. Këshillohet që të mënjanohet ekspozimi në diell i bimëve mjekësore dhe aromatike të thara më përpara në hije, sepse ato humbasin ngjyrën.

ç) Tharja me ngrohje artificiale. Që bimët të ruajnë ngjyrën e tyre karakteristike, është e nevojshme që ngrohja të mos jetë shumë e fortë. Kufiri i temperaturës lëkundet ndërmjet 20 e 30⁰C për ato më delikate (lulet, gjethet aromatike, etj.) dhe 50 – 60⁰C për bimët që thahen me vështirësi (sanza, shtara, etj.). Dihet se tharja artificiale e bimëve mjekësore dhe aromatike është më e mirë dhe më e shpejtë se ajo natyrore, sepse temperatura mund të rregullohet sipas natyrës së bimëve që duhen tharë. Po ashtu, tharja artificiale mund të bëhet në çdo kohë dhe në çdo stinë.

8.3 Përshkrimi botanik dhe përhapja e disa bimëve mjekësore dhe aromatike

Aguliçja (*Primula officinalis* L.)

Përshkrimi botanik: Në gjuhën popullore quhet lulepranvere. Është bimë barishtore shumëvjeçare. Gjethet i ka të grumbulluara në fund të kërcellit, në formë bazale. Llapa e gjethes është gjatësore, në formë vezake të zgjatur. Lulet i ka të mëdha, të verdha, të renditura në ombrellë të thjeshtë. Lulëzon në prillit – qershor. Përhapja: Është bimë e zakonshme dhe gjendet kudo në kullota e livadhe subalpine e alpine. Përbërja kimike: Përmban kryesisht saponinë dhe esencë, glukozide fenolike (primaverinë dhe primulaverinë), pak taninë, acid silicilik, etj. Rrënjët përmbajnë saponinë, glukozidet primulaverinë e primverinë, vaj esencial, lëndë muçilagjinoze, sheqer, lëndë regjëse, fermentin primverazë, vitaminë C, etj. Gjethet rrënjake në gjendje të njomë përmbajnë deri 1100 mg% vitaminë C.




Boronica (*Vaccinium myrtillus* L.)

Përshkrimi botanik: Në gjuhën popullore quhet edhe qershitoke, thrashegër, qersh i egër, rrush mali. Është shkurrëz deri 0,6 m e lartë. Ka gjethë vezake, me buzë të dhëmbëzuara; lule të vetmuara në sqetullat e gjethëve, me ngjyrë rozë në të gjelbër. Lulet janë dyseksore, të rregullta, me kupë të përbërë nga 4-5 nënpetla, me kororë me 4-5 petla, me 8-10 thekë dhe me një pistil të përbërë nga 4-5 karpela. Lulet kanë ngjyrë të gjelbër ose

trëndafili. Frutet janë baka të zeza me lëng vjollcë. Lulëzon në maj – korrik dhe frutifikon në korrik – shtator. Përhapja: Boronica është e përhapur në pyje e livadhe të zonave malore të vendit, sidomos në pyjet e ahut dhe në kullota subalpine e alpine. etj.

Caji i malit (*Sideritis roeseri* L.)

Përshkrimi botanik: Është bimë barishtore shumëvjeçare, me gjethë të përkundrejta, kërcell katërkëndor, kurorë buzore. Gjethet kanë erë karakteristike, që e dallon nga bimët e tjera. Përhapja: Rritet në vende të thata kodrinore e malore të zonës subalpine, të zonës së dushkut dhe asaj të makjes. Rritet edhe në zona fushore, anës rrugëve dhe kanaleve, në suka e kodrina. Pëlqen toka gëlqerore.



Lavanda (*Lavandula vera*.)

Përshkrimi botanik: Është shkurre, që shkon në lartësi 30 – 60 cm. E kultivuar, si bimë aromatike, njihet me emrin *Lavandula vera* DC. Prej kërcellit dalin degë të thjeshta, të gjata, të holla, katërkëndëshe, të


pajisura me gjethe në bazë e me lule në majë. Gjethet i ka të përkundrejta, pa bisht, të ngushta, vezake, gjatësore, heshtake, të plota. Lulëzon gjatë muajve qershor – korrik

Lulebasani (*Hypericum perforatum* L.)

Përshkrimi botanik: Në gjuhën popullore quhet edhe agurdhusë e shpuar, balç, bar i të premit, lule maji, balq, lulja e gjakut. Është bimë barishtore, shumëvjeçare. Prej rizomës së hollë, të degëzuar, dalin çdo vit disa kërcëj të drejtë, të degëzuar, të lëmuar, që arrijnë lartësinë 20 - 60 cm. Gjethet i ka të përkundrejta, pa bisht, gjatore, të pajisura anës me pika të vogla, të verdha në të artë dhe me pika të zeza në të murrme nga ana e jashtme. Lulëzimi bëhet gjatë majit deri në korrik.

Sanza (*Gentiana lutea* L.)

Përshkrimi botanik: Në gjuhën popullore quhet edhe bar zemre, agushe, sancë, ksanë, raven. Është bimë barishtore, shumëvjeçare, e rastësishme. Ka rrënjë të gjata 60 - 90 cm, të trasha, të tulta, të degëzuara, cilindrike, me ngjyrë të murrme përsipër e të verdhë si në të kuqe brenda. Vitet e para bima nxjerr vetëm një rozetë gjethesh pranë rrënjës dhe vitin e tretë ose të katërt zhvillon kërcellin e fillon të lulëzojë. Më pas lulëzon çdo vit. Kërcellin e ka të drejtuar përpjetë, të padegëzuar, 60 - 150 cm të lartë, me ngjyrë të gjelbër. Gjethet të përkundrejta, vezake, të plota, me 5 - 7 damarë të dukshëm, të sipërmet pa bisht, të kundërngjitura, të poshtmet shumë të mëdha, 20 - 30 cm të gjata e 6 - 15 cm të gjera, eliptike, me bisht të shkurtër. Lulet i ka të mëdha, të verdha, me bisht të shkurtër, të vendosura në sqetullat e gjetheve të sipërme, në formë tufash.: Sanëza takohet në zonën e ahut dhe atë të dushqeve. Preferon toka me natyrë gëlqerore, granitike,



Sherbela (*Salvia officinalis* L.)


Përshkrimi botanik: Në gjuhën popullore quhet edhe bedunicë, kalifere, hamosfakë, mirosfakë, gjymash, salbi, stërbelë, sulbelë, sfakë, dunicë mali. Është shkurrëz, që në kushtet tona rritet 40 - 80 cm. Kërcejtë, në përgjithësi, janë shumë të degëzuar. Degët njëvjeçare janë të buta, me ngjyrë hiri në krem, me push, të holla. Degët e vjetra kanë lëvore me luspa ngjyrë hiri në kafe. Si njëvjeçarët edhe shumëvjeçarët përbëhen prej katër këndesh. Çdo vit degët e sipërme thahen, kurse të poshtmet nuk pësojnë ndryshime. Gjethet janë të përkundrejta, gjatore-vezake dhe të ngushta-eliptike, të trasha, të rrudhura, shpesh të pajisura me dy pendë të vogla, me push të dendur. Ato rriten 3-12 cm të gjata dhe 0,4-2,8 cm të gjera. Ngjyra e gjetheve ndryshon sipas klimës dhe tokës, nga jeshile në hiri, nga hiri në të verdhë ose me nuanca hiri të gjelbër në të verdhë ose krejtësisht të gjelbër. Lulet kanë ngjyrë manushaqe dhe rrallë të bardha. Ato formojnë një kallë të rremë të gjithanshëm prej vermicelesh me 3 - 8 lule të pajisura me një brakte vezake në formë zemre. Fruti përbëhet nga 4 akene trekëndëshe. Farat janë pothuaj të rrumbullakta (sferike), 2-3 mm të gjata e 2 mm të gjera, të shënuara me pika, me ngjyrë kafe të errët deri në të zeshkët, kurse në pjesën e brendshme janë të bardha. Koha e lulëzimit ndryshon sipas pozicionit gjeografik dhe klimës. Kështu, në zonën bregdetare të lulëzimi fillon në maj dhe vazhdon deri në fund të qershorit, kurse më në brendësi dhe në zonën e ftohtë, lulëzimi fillon nga fundi i majit dhe

vazhdon deri nga fillimi i korrikut. Përhapja: Sherbela është bimë kserofite, tipike mesdhetare dhe si vend saj cilësohet bregdeti Adriatik, deri në fund të Jonit..

Gjendet me pakicë, në toka të thata e të papunuara, anës rrugëve, nëpër hendeqe dhe anës gjerdheve.

Trumza (*Saturea montana* L.)

Përshkrimi botanik: Në gjuhën popullore quhet edhe kraskë, shtermen, trumzë bleta, vjesker. Është shkurrëz ose gjysmë shkurre, deri 50 cm e lartë. Rrënjët i ka boshtore, të forta, me ngjyrë kafe të çelur deri në kafe të errët, rrënjët anësore janë të çelura, shumë të degëzuara dhe me shumë fije. Kërcellin e ka të lartë, me 4 qoshe shytë deri pothuaj të rrumbullakët, me shumë degë të shogëta e të drejta. Drunjëzohet shpejt dhe është e rrethuar nga një lëvore pak a shumë në trajtë mëndafshi të shkëqyeshme, e cila hiqet lehtë. Gjethet i ka lëkurore, të gjelbra, të shogëta, pak të shkëlqyeshme, të qepikëta anëve, me buzë të plota, me majë të mprehtë, vezake, heshtore, pak a shumë të rrumbullakta, pa bisht, të dallueshme dhe pa nerva anësore. Lulet janë të grumbulluara nga 3-7 në sqetullat e gjetheve. Kanë gjethëza mbuluese vizake, pykore. Lulëzon një kohë të gjatë, nga qershori deri në korrik ose deri në shtator. Përhapja: Është e përhapur pothuaj në të gjitha zonat, ka kërkesa shumë të pakta karshi vendit ku rritet. Preferon toka gëlqerore, të thata, mundësisht të ngrohta.



Xherokulli (*Colchicum autumnale* L.)

Përshkrimi botanik: Në gjuhën popullore quhet edhe boqes, kaçe, bar plakash, bar i thëmthit, lule buç, gace-ja, kokërr, boqër, kollër, lule mjeshtri. Është bimë barishtore, me cikël karakteristik zhvillimi. Takohet ose vetëm më lule ose vetëm me gjethë. Lulëzon në gusht-shtator, pranverën tjetër nxjerr gjethë e fruta, ndërsa në verë, qershor-korrik, frutat piqen dhe lëshojnë farat. Gjethet thahen dhe mbi tokë nuk mbetet asnjë gjurmë e bimës. Në vjeshtë, cikli i zhvillimit përsëritet. Qepa (zhardhoku) është e trashë sa një gështenjë, 3-4 cm e gjatë dhe 2-3 cm e gjerë. Zhvillimin e saj të plotë e ka në pranverë. Ajo përmban nën lëkurë, në pjesën e sipërme dhe anësore, një bulb të ri, të madh sa një bizele, që zhvillohet e rritet brenda tre muajve. Gjatë kësaj kohe, qepa e vjetër, që i ka konsumuar rezervat e saj ushqimore, thahet. Ajo fishket kur formohet qepa e re. Qepa e re nxjerr mbi tokë 1-3 lule të mëdha dhe të bukura. Gjethet, që dalin në pranverë, bëhen 20-30 cm të gjata dhe 2-3 cm të gjera, me ngjyrë të gjelbër të errët dhe të bashkuara formojnë një rozetë, në mesin e të cilave formohet fruti. Lulet me ngjyrë jargavani të çelur, janë të renditura në cima njëpjellëse.

Lista e bimeve mjekesore

Emri shqip		Emri latinisht
1	Agulicja	<i>Primula officinalis</i>
2	Akja	<i>Helichrysum arenarium</i>
3	Anasoni	<i>Pimpinella anisum</i>
4	Agjinarja	<i>Cynara scolimus</i>
5	Arra	<i>Juglans regia</i>
6	Arksi	<i>Teucrium chamaedrys</i>
7	Bargjaku	<i>Lythrum salicaria</i>
8	Bar majasëlli	<i>Teucrium polium</i>
9	Bari i shpetkës	<i>Verbena officinalis</i>
10	Bar veshi	<i>Sempervivum tectorium</i>
11	Bërshëlliza	<i>Convolvulus sepium</i>
12	Bishtamithi	<i>Achillea millefolium</i>
13	Bliri	<i>Tilia platyphyllos</i>
14	Boronica	<i>Vaccinium myrtillus</i>
15	Borziloku	<i>Ocimum Basilicum</i>
16	Bushi	<i>Buxus sempervirens</i>
17	Çaji i Evropës	<i>Thea sinensis</i>
18	Çaji i Malit	<i>Sideritis roeseri</i>
19	Çikore	<i>Cichorium intybus</i>
20	Dafina	<i>Laurus nobilis</i>
21	Dëllinja	<i>Juniperi communis</i>
22	Drunakuqi	<i>Frangula alnus</i>
23	Drydhëmbëshi trepjesësh	<i>Bidens Tripartitus</i>
24	Elbi	<i>Hordeum vulgare</i>
25	Fasulja	<i>Phaseolus vulgaris</i>
26	Fiku	<i>Fikus carica</i>
27	Fik Ujku	<i>Aristolochia clematidis</i>
28	Fomi Mjekësor	<i>Fumaria officinalis</i>
29	Frashëri i Bardhë	<i>Fraxinus ornus</i>
30	Ftoi	<i>Cydoniae</i>
31	Fshesa e Keqe	<i>Erigeron canadensis</i>
32	Gërdeci	<i>Aretostaphylos Urvae Ursi</i>
33	Gështenja	<i>Castanea sativa</i>
34	Gështenja e Egër	<i>Aesculus Hippocastanum</i>
35	Grami	<i>Cynodon dactylon</i>
36	Grunamadhi	<i>Melilotus officinalis</i>
37	Gjarpër Mjekësor	<i>Ceterach officinarum</i>
38	Gjembabardha	<i>Eryngium campestre</i>
39	Gjembgomari	<i>Silybum marianum</i>
40	Gjethedelli	<i>Plantago major</i>
41	Gjineshtra ngjyruese	<i>Genista tinctoria</i>
42	Gjuhëusja	<i>Ononis spinosa</i>
43	Herniarja	<i>Herniaria glabra</i>
44	Hithra	<i>Urtica dioica</i>
45	Hudhra	<i>Allium sativum</i>
46	Kafeja	<i>Coffea arabica</i>
47	Kamomili	<i>Matricaria chamomilla</i>
48	Kapinoku	<i>Marrubium vulgare</i>
49	Karajpeli	<i>Tanacetum vulgare</i>
50	Karrota	<i>Daucus carota</i>
51	Kemashen me qime	<i>Hieracium pilosella</i>
52	Këputja	<i>Equisetum arvense</i>
53	Kinëfusha	<i>Erythraea centaureum</i>
54	Kokoçelli	<i>Centarea cvanus</i>
55	Kopra e egër	<i>Foeniculum vulgare</i>
56	Koriandri	<i>Koriarum sativum</i>
57	Kufilma	<i>Symphytum officinale</i>
58	Kulumbri	<i>Prunus spinosa</i>
59	Kumaku	<i>Calendula officinalis</i>
60	Kungulli	<i>Curcuma pepo</i>
61	Lajthia	<i>Corylus avellana</i>
62	Lakra	<i>Brassica oleracea</i>
63	Leonuri i zemrës	<i>Leonurus cardiaca</i>
64	Likopësi	<i>Lycopus europaeus</i>
65	Limoni	<i>Citrus limonum</i>
66	Liri	<i>Linum usitatissimum</i>
67	Livando (trumza)	<i>Lavandula officinalis</i>
68	Lulebasani	<i>Hypericum perforatum</i>
69	Luledelja	<i>Bellis perrenis</i>
70	Luledielli	<i>Helianthus annuus</i>
71	Lulëkuqja	<i>Papaver rhoeas</i>
72	Lulelepuri	<i>Pulmonaria officinalis</i>
73	Lulështrydhe	<i>Fragaria vesca</i>
74	Llopoi	<i>Petasites hybridus</i>
75	Majdanozi	<i>Petroselinum hortense</i>
76	Majdanozi i egër	<i>Adiantum capillus-veneris</i>
77	Manaferra	<i>Rubus fruticosus</i>
78	Mani (i zi dhe i bardhë)	<i>Morus nigra & morus alba</i>
79	Manushaqja	<i>Viola odorata</i>
80	Manushaqja e egër	<i>Viola tricolor</i>
81	Manxurana	<i>Majorana hortensis</i>
82	Mareja	<i>Arbutus unedo</i>
83	Melakja	<i>Geum urbanum</i>
84	Mëlqinja	<i>Berberis vulgaris</i>
85	Mendra e butë	<i>Mentha piperita</i>
86	Mersina	<i>Myrtus communis</i>
87	Mëllaga	<i>Malva silvestris</i>
88	Mëllaga e bardhë	<i>Althea officinalis</i>
89	Mështekna	<i>Betula verrucosa</i>
90	Mërtiku	<i>Vinca major</i>
91	Milca	<i>Melissa officinalis</i>
92	Misri	<i>Zea mays</i>
93	Mjedra	<i>Rubus idaeus</i>
94	Murrizi	<i>Crataegus oxyacantha</i>
95	Nejça e përdredhur	<i>Polygonum bistorta</i>
96	Nejça si piper uji	<i>Polygonum hydropiper</i>
97	Nerënxa	<i>Citrus amara</i>
98	Netulla	<i>Verbascum phlomoides</i>
99	Parietarja mjekësore	<i>Parietaria officinalis</i>
100	Pata	<i>Polygonum aviculare</i>
101	Pelini	<i>Artemisia absinthum</i>
102	Pelini i zi	<i>Artemisia vulgaris</i>
103	Pisha	<i>Pinus Turiones</i>
104	Pjepri i egër	<i>Ecballii elaterum Rich</i>
105	Plepi i zi	<i>Populis nigra</i>
106	Podiqja	<i>Agrimonia eupatoria</i>
107	Polipoda	<i>Polypodium vulgare</i>
108	Prasi	<i>Allium porrum</i>
109	Pulithi	<i>Senecio vulgaris</i>
110	Purqarku	<i>Nasturtium officinale</i>
111	Qepa	<i>Allium cepa</i>
112	Qerbashi	<i>Galea officinalis</i>
113	Qingla	<i>Sambucus ebulus</i>
114	Radhiqja	<i>Taraxacum officinale</i>
115	Rigoni	<i>Origanum vulgare</i>
116	Rozmarina	<i>Rosmarinus officinalis</i>
117	Rrepa	<i>Raphanus sativus</i>
118	Rrënja dhe bunga	<i>(Quercus robur & petraea)</i>
119	Rrodhe e madhe	<i>Arctium lappa</i>
120	Rrushqyqja	<i>Sedum acre</i>
121	Salepi	<i>Orchis</i>
122	Sanza	<i>Gentiana lutea</i>
123	Selvia	<i>Cupressus semprevirens</i>
124	Senameqi (sena)	<i>Cassia angustifolia</i>
125	Sinapi	<i>Brassica nigra</i>
126	Solidagia Shufër Artë	<i>Solidago vir-gaurea</i>
127	Speci djegës	<i>Capsicum annum</i>
128	Stërkungulli	<i>Bryoniae dioica</i>
129	Sumullari	<i>Humulus lupulus</i>
130	Shaja mjekësore	<i>Borago officinalis</i>
131	Shega	<i>Punica granatum</i>
132	Shelgu	<i>Salix alba</i>
133	Sherbela	<i>Salvia officinalis</i>
134	Shkumbajka	<i>Saponaria officinalis</i>
135	Shpatorja	<i>Iris pallida Lamarck</i>
136	Shtogu	<i>Sambucus nigra</i>
137	Shtrepëri	<i>Capsella bursa pastoris</i>
138	Tortilis	<i>Tortilis nodosa</i>
139	Tëmlagjaku	<i>Chelidonium majus</i>
140	Tërfili i livadheve	<i>Trifolium pratense</i>
141	Tërshëra	<i>Avena sativa</i>
142	Thundërmushka	<i>Tussilago farfara</i>
143	Trëndafili i egër	<i>Rosa canina</i>
144	Trumza	<i>Satureja montana</i>
145	Ulliri	<i>Olea europea</i>
146	Udhri	<i>Hedera helix</i>
147	Vadhja e egër	<i>Sorbus aucuparia</i>
148	Valeriana	<i>Valeriana officinalis</i>
149	Verru i zi	<i>Alnus glutinosa</i>
150	Vidhi	<i>Ulmus campestris</i>
151	Vishnja dhe qershia	<i>Cerasus vulgaris & avium</i>
152	Vjeshjtulla e bardhë	<i>Viscum album</i>
153	Zhumbrica	<i>Thymus longicaulis</i>

**LISTA E LLOJEVE KRYESORE, DRURE E SHKURRE PYJORE
E ZBUKURUESE**

Emri shqip	Emri latin	Emri anglisht
Ahu	<i>Fagus sylvatica L.</i>	Common Beech
Ajdësi	<i>Laburnum anagyroides</i>	Common Laburnum
Ajdësi i alpeve	<i>Laburnum alpinum (Mill)</i>	Alpine Laburnum
Akacia	<i>Robinia pseudoacacia L.</i>	Locust Tree
Albizia	<i>Albizia julibrissin Durazz.</i>	Pink Siris
Arneni	<i>Pinus peuce Gris.</i>	Macedonian Pine
Arrë Hindi	<i>Ailanthus altissima (Mill)</i>	Tree of Heaven
Arra	<i>Juglans regia L.</i>	Common Walnut
Ashja	<i>Ilex aquifolium L.</i>	Common Holly
Bafra	<i>Pistacia terebinthus L.</i>	Turpentine Tree
Bërsheni	<i>Juniperus foetidissima</i>	Juniper
Bezga	<i>Phlomis fruticosa L.</i>	Jerusalem Sage
Bulgri	<i>Quercus trojana Webb in</i>	Macedonian Oak
Bliri i argjentë	<i>Tilia argentea Desf.</i>	Silver Lime
Bliri fletëgjërë	<i>Tilia platyphyllos Scop.</i>	Large-leaved Lime
Bliri fletëvogël	<i>Tilia cordata Mill.</i>	Small-leaved Lime
Bungbuta	<i>Quercus pubescens Willd.</i>	Downy Oak
Boshtëra	<i>Forsythia europea</i>	European Forsythia
Boronica	<i>Vaccinium uliginosum L.</i>	Blueberry
Bredhi i bardhë	<i>Abies alba Mill.</i>	Common Silver Fir
Bredhi i Greqise	<i>Abies cephalonica Lond.</i>	Grecian Fir
Bredhi i Maqedonisë	<i>Abies borisii-regis Matt.</i>	Macedonian Fir
Bushi	<i>Buxus sempervirens L.</i>	Box
Bulini	<i>Ulmus laevis Pall.</i>	European White Elm
Butina e butë	<i>Viburnum lantana L.</i>	Wayfaring Tree
Bunga	<i>Quercus petraea Liebl.</i>	Sessile Oak
Caraci	<i>Celtis australis L.</i>	Nettle-tree
Cermédelli	<i>Cotinus coggygria Scop.</i>	Smoke Tree
Cedri i Himalajeve	<i>Cedrus deodara (D.Don.)</i>	Himalayan Cedar
Cedri i Libanit	<i>Cedrus libani A.Richard</i>	Cedar of Lebanon
Dardha e egër	<i>Pyrus communis L.</i>	Common Pear
Dafina	<i>Laurus nobilis L.</i>	Sweet Bay
Dëllinja e kuqe	<i>Juniperus oxycedrus L.</i>	Prickly Juniper
Dëllinja e zezë	<i>Juniperus communis L.</i>	Common Juniper
Driza	<i>Paliurus spina-christi Mill.</i>	Christ's Thorn
Dugllasi	<i>Pseudotsuga menziesii</i>	Douglas Fir
Eukalpte lloje	<i>Eucalyptus L'Her. (sp.)</i>	Eucalyptus sp.
Fshikakuqi fletëgjërë	<i>Euonymus latifolius (L) Mill.</i>	Broad-leaved Spindle
Fidhesi	<i>Juniperus phoenica L.</i>	Phoenician Juniper
Fiku	<i>Ficus carica L.</i>	Fig Tree
Fshikakuqi i malit	<i>Euonymus verrucosa Scop.</i>	Mountain Spindle-Tree

Frashëri i bardhë	<i>Fraxinus ornus L.</i>	Manna Ash
Frashëri gjethengushtë	<i>Fraxinus angustifolia Vahl.</i>	Narrow-leaved Ash
Frashëri i zi	<i>Fraxinus excelsior L.</i>	Common Ash
Fshikëkartha	<i>Colutea arborescens L.</i>	Bladder Sena
Gështenja	<i>Castanea sativa Mill.</i>	Sweet Chestnut
Gështenja e kalit	<i>Aesculus hippocastanum L.</i>	Common Horse
Gjineshtra ngjyese	<i>Genista tinctoria L.</i>	Dyer's Greenwood
Gledicja	<i>Gleditschia triacanthos L.</i>	Honey Locust
Gorica	<i>Pyrus amygdaliformis Pall.</i>	Almond-leaved Pear
Grathata	<i>Erica carnea L.</i>	Spring Heather
Hartina	<i>Pinus silvestris L.</i>	Scots Pine
Hidhësi	<i>Ulmus glabra Huds.</i>	Wych Elm
Hipofaja	<i>Hippophae rhamnoides L.</i>	Sea Buckthorn
Hormoqi	<i>Picea excelsa Link</i>	Norway Spruce
Hunapi	<i>Eleagnus angustifolia L.</i>	Oleaster
Ilqja	<i>Quercus ilex L.</i>	Holm Oak
Jargavani	<i>Syringa vulgaris L.</i>	Common Lilac
Karagana	<i>Caragana arborescens Lam.</i>	Caragana
Kërleka	<i>Pinus mugo Turra.</i>	Mountain Pine
Konopica	<i>Vitex agnus-castus L.</i>	Vitex
Kokoreci i butë	<i>Pistacia vera L.</i>	Pistachio
Krekëza fletëmadhe	<i>Acer campestre L.</i>	Field Maple
Krekëza fletëvogël	<i>Acer monspessulanum L.</i>	Montpelier Maple
Kulfini	<i>Alnus cordata Desf.</i>	Italian Alder
Kullumbria	<i>Prunus spinosa L.</i>	Blackthorn
Lajthia e butë	<i>Corylus avellana L.</i>	Common Hazel
Laverdhëza drungurtë	<i>Lonicera xylosteum L.</i>	Honeysuckle
Lajthia e egër	<i>Corylus colurna L.</i>	Turkish Hazel
Larshi	<i>Larix decidua Mill.</i>	Common Larch
Lofata	<i>Cercis siliquastrum L.</i>	Judas Tree
Mani i bardhë	<i>Morus alba L.</i>	White Mulberry
Marina e Dalmacisë	<i>Tamarix dalmatica Baum.</i>	Dalmat Tamarisk
Manaferra	<i>Rubus ulmifolius Schatt.</i>	Blackberry
Marina dëllinjë	<i>Tamarix juniperina Bunge.</i>	Juniper Tamarisk
Marina e kuqe	<i>Tamarix parviflora DC.</i>	Tamarisk
Mareja	<i>Arbutus unedo L.</i>	Strawberry Tree
Mani i zi	<i>Morus nigra L.</i>	Common Mulberry
Mëlleza	<i>Ostrya carpinifolia Scop.</i>	Hop Hornbeam
Menishte lloje	<i>Cistus spp.</i>	Rock rose unspecified
Mërsina	<i>Myrtus communis L.</i>	Common Myrtle
Mjedra	<i>Rubus idaeus L.</i>	Raspberry
Mëllagjeri	<i>Arbutus andrachne L.</i>	Eastern Strawberry Tree
Molle lloje	<i>Malus L. (sp)</i>	Apples
Mreta e ndërmjetme	<i>Phillyrea media L.</i>	Common Phillyrea
Mreta gjethgjërë	<i>Phillyrea latifolia L.</i>	Broad-leaved Phillyrea

Mreta gjethengushtë	<i>Phillyrea angustifolia L.</i>	Narrow-leaved Phillyrea
Mështekna	<i>Betula pendula Roth.</i>	Silver Birch
Murrizi i butë	<i>Crataegus orientalis Pall.</i>	Oriental Thorn
Murrizi i heldraikit	<i>Crataegus heldreichii Boiss.</i>	Heldreich's Hawthorn
Murrizi 5 berthamesh	<i>Crataegus pentagyna</i>	Hawthorn
Murrizi njëbërthamësh	<i>Crataegus monogyna Jacq.</i>	Common Hawthorn
Mylqine	<i>Eriobotrya japonica</i>	Loquat
Mëzhdredha	<i>Cerasus mahaleb Mill.</i>	Saint Lucie Cherry
Oleanderi	<i>Nerium oleander L.</i>	Oleander
Palma lloje	<i>Palmae (Sp.)</i>	Palm Tree sp.
Panja amerikane	<i>Acer negundo L.</i>	Box-elder
Panja e butë	<i>Acer hyrcanum Fisch et</i>	Balkan Maple
Panja fletëgjërë	<i>Acer obtusatum Waldst et</i>	Broad-leaved Maple
Panja gjetherrap	<i>Acer platanoides L.</i>	Norway Maple
Panja e Heldraikit	<i>Acer heldreichi Orph. ex</i>	Heldreich's Maple
Panja e malit	<i>Acer pseudoplatanus L.</i>	Sycamore
Pisha e bute	<i>Pinus pinea L.</i>	Stone Pine
Pishe deti	<i>Pinus Pinaster</i>	Maritime Pine
Pisha e egër	<i>Pinus halepensis Mill.</i>	Aleppo Pine
Pisha e Kalifornisë	<i>Pinus radiata Don.</i>	Monterey Pine
Pisha brutia	<i>Pinus brutia Ten.</i>	Calabrian Pine
Pisha e zeze	<i>Pinus nigra Arn.</i>	Austrian Pine, Black Pine
Pjerza dliuruese	<i>Rhamnus catharticus L.</i>	Purge Buckthorn
Pjerza lloje	<i>Rhamnus (sp.)</i>	Rhamnus sp.
Plepi	<i>Populus canescens Ait.</i>	Grey Poplar
Plepi i bardhë	<i>Populus alba L.</i>	White Poplar
Plepi i egër	<i>Populus tremula L.</i>	Aspen
Plepi i Kanadasë	<i>Populus x canadensis</i>	Hybrid Black Poplar
Plep lloje	<i>Populus sp.</i>	Poplar sp.
Plepi i zi	<i>Populus nigra L.</i>	Black Poplar
Pralli	<i>Quercus coccifera L.</i>	Scarlet Oak
Pisha e bardhë	<i>Pinus strobus L.</i>	White Pine
Qarri	<i>Quercus cerris L.</i>	Turkey Oak
Qershia e egër	<i>Cerasus avium Moench.</i>	Gean
Qelbësi	<i>Anagyris foetida L.</i>	Common Anagyris
Rrapë	<i>Platanus orientalis L.</i>	Oriental Platane
Rrobulli	<i>Pinus heldreichi Christ.</i>	Bosnian Pine
Rrenja	<i>Quercus robur L.</i>	English Oak
Rrushkulli	<i>Ruscus aculeatus L.</i>	Butcher's Broom
Shelgu i bardhë	<i>Salix alba L.</i>	White Willow
Shelgu vajtues	<i>Salix babylonica L.</i>	Chinese Weeping Willow
Shelgu i egër	<i>Salix caprea L.</i>	Pussy Willow
Shelgu i përhimë	<i>Salix cinerea L.</i>	Grey Willow
Shelgu i butë	<i>Salix eleagnos Scop.</i>	Hoary Willow
Shelgu i thyeshëm	<i>Salix fragilis L.</i>	Crack Willow

Sherbela	<i>Salvia officinalis</i>	Sage
Shega	<i>Punica granatum L.</i>	Pomegranate
Shkoza e bardhë	<i>Carpinus betulus L.</i>	Hornbeam
Shkoza e zeze	<i>Carpinus ornus</i>	Hornbeam
Shparthi	<i>Quercus frainetto Ten.</i>	Hungarian Oak
Shqeme	<i>Rhus coriaria L.</i>	Sumach
Shkoza e zezë	<i>Carpinus orientalis Mill.</i>	Eastern Hornbeam
Skербulli	<i>Amorpha fruticosa L.</i>	False Indigo
Selvia	<i>Cupressus sempervirens L.</i>	Italian Cypress
Shelgu i kuq	<i>Salix purpurea L.</i>	Red Willow
Shqopa e butë	<i>Erica arborea L.</i>	Heath Tree
Shqopa e egër	<i>Erica verticillata Fors.</i>	Heather
Shtogra	<i>Staphylea pinnata L.</i>	Needle Staphyllea
Shtogu i kuq	<i>Sambucus racemosa L.</i>	Alpine Elder
Shelgu fletëbajame	<i>Salix triandra L.</i>	Almond Willow
Shtogu i zi	<i>Sambucus nigra L.</i>	Elder
Shelgu industrial	<i>Salix viminalis L.</i>	Common Osier
Thana	<i>Cornus mas L.</i>	Cornelian Cherry
Thrashegra	<i>Vaccinium myrtillus L.</i>	Bilberry
Thanukla	<i>Thelycrania sanguinea L.</i>	Thelycrania Tree
Tisi	<i>Taxus baccata L.</i>	Common Yew
Timus lloje	<i>Thymus spp.</i>	Thyme unspecified
Trëndafili i egër	<i>Rosa canina L.</i>	Dog-rose
Ulëza	<i>Acer tataricum L.</i>	Tartar Maple
Ulliri	<i>Olea europea/Olive</i>	Olive
Urthi	<i>Hedera helix L.</i>	Common Ivy
Ushinthi	<i>Pyracantha coccinea Roem.</i>	Firethorn
Vadhëviçja	<i>Sorbus torminalis Crantz.</i>	Wild Service Tree
Vadhëviçja e bardhë	<i>Sorbus aria L.</i>	Whitebeam
Vadhja	<i>Sorbus domestica L.</i>	True Service Tree
Vadhëza e egër	<i>Sorbus aucuparia L.</i>	Rowan, Mountain Ash
Valanidhi	<i>Quercus macrolepis</i>	Grecian Oak
Venja	<i>Juniperus excelsa Bieb.</i>	Grecian Juniper
Vërriu i bardhë	<i>Alnus incana L.</i>	Grey Alder
Vërriu i zi	<i>Alnus glutinosa L.</i>	Common Alder
Vidhi i fushës	<i>Ulmus foliacea Gilib.</i>	English Elm
Vjezhdull	<i>Viscum album L.</i>	Mistletoe
Vjexhesi lloje	<i>Cytisus sp.</i>	Broom sp.
Voshtra e rëndomtë	<i>Ligustrum vulgare L.</i>	Common Privet
Xana, (Gjineshtra)	<i>Spartium junceum L.</i>	Spanish Broom
Xhixhibanozi	<i>Ceratonia siliqua L.</i>	Carob
Xina	<i>Pistacia lentiscus L.</i>	Mastic Tree
Zogla lloje	<i>Frangula sp.</i>	Frangula sp.
Zogla vërrë	<i>Frangula alnus Mill.</i>	Alder Buckthorn